

## Referendumi

VMRO nuk do të thërret në bojkot

Fq.3



## ASHAM

Konfirmohet identiteti dhe gjuha maqedonase

Fq.4



Humbja me Skocinë lëkund pozitën e Panuccit

Fq.19



# Koha

www.koha.mk



Si reagoi Bushi në 11 shtatorin e kobshëm

Fq.13

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3457 · e mërkurë, 12 shtator 2018

15°C | 27°C

15 DEN

### AKTUALE

**KYLE SCOTT:**  
Ende ka mundësi për marrëveshje Kosovë -Serbi



Një mbështetje nga SHBA-ja, Rusia dhe Gjermania do të ishte e nevojshme për implementimin e një marrëveshje, por thekson se puna kryesore për të arritur një marrëveshje të tillë duhet të bëhet nga Prishtina dhe Beogradi

Fq.2

### DOSSIER

Si e shihnin Shqipërinë turistët në vitet 1930

Fq.14

### RAJON

Nga e hëna hyn në funksion tarifa për Rrugën e Kombit

Fq.16



## PREZANTOHET DËSHMIA KYÇE E RASTIT "MONSTRA"

# PSE "OMEGA" U FSHEH GJASHTË VITE?

Fshehja e veturës "Opell Omega" si provë relevante në rastin "Monstra" u zbulua pas gjashtë viteve. Faktin se pse kjo veturë nuk i është prezantuar palës mbrojtëse dhe të akuzuarve nuk dëshironin ta komentojnë as nga Gjykata Penale e Shkupi dhe aq më pak nga Prokuroria Speciale Publike. Në seancat e radhës të caktuara për muajin tetor sipas të gjitha gjasave do të diskutohen edhe detajet lidhur me këtë dëshmi

Fq.5



## Studentët frikësohen t'i denoncojnë profesorët

Shkup, 11 shtator - Në Universitetin e Evropës Juglindore u mbajt Konferenca Ndërkombëtare me temën korrupsion në arsimin e lartë si pjesë e projektit "Universitete pa korrupsion" në organizim të Institutit për hulumtime strategjike dhe edukim (IHSE) dhe mbështetjen e SHBA në Maqedoni. Pjesëmarrës në këtë konferencë ishin profesorë universitar nga Maqedonia, Shqipëria, Kroacia, Italia, Serbia, Britania dhe Amerika të

cilët tregun shkaqet e korrupsioni në sferën e arsimin në Maqedoni. Korrupsioni në arsim sipas profesorëve pjesëmarrës dhe hulumtimeve të bëra është si rezultat i ekonomisë, traditës, standardeve jetësore dhe politikës. Për Gazetën KOHA, Aleksandra Denoska Trendafilova nga Fakulteti i Juridikut "Justiniani i Parë" i Shkupit deklaroi se ky projekt ka filluar me nënshkrimin e një deklaratë nga ana e universiteteve shtetërore...

Fq.6





## KYLE SCOTT: ENDE KA MUNDËSI PËR MARRËVESHJE KOSOVË -SERBI

Një mbështetje nga SHBA-ja, Rusia dhe Gjermania do të ishte e nevojshme për implementimin e një marrëveshje, por thekson se puna kryesore për të arritur një marrëveshje të tillë duhet të bëhet nga Prishtina dhe Beogradi.

Ambasadori i SHBA-së, Kyle Scott, ka folur të martën rreth arritjes së një marrëveshjeje përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ai ka thënë se për këtë nevojitet një mbështetje nga fuqitë e mëdha, megjithatë puna kryesore sipas tij mbetet tek Prishtina dhe Beogradi.

"Mendoj se një marrëveshje ndërmjet Serbisë dhe Kosovës është ende e mundur, dhe shpresoj se liderët e rajonit do ta mbështesin këtë, sepse ne e kemi mundësinë për të ndërtuar marrëveshje për paqe dhe stabilitet" ka thënë ambasadori i SHBA-së gjatë një vizite në Kryqin e Kuq.

Ai ka thënë se Beogradi dhe Prishtina duhet ta arrijnë një marrëveshje e cila do të jetë e përhershme.

Ai ka thënë se një mbështetje nga SHBA-ja, Rusia dhe Gjermania do të ishte e nevojshme për implementimin e një marrëveshje, por thekson se puna kryesore për të arritur një marrëveshje të tillë duhet të bëhet nga Prishtina dhe Beogradi.

Scott ka folur edhe rreth deklarimeve të senatorit Ron Johnson i cili ka thënë se SHBA-ja ende nuk ka vendosur vija të kuqe sa i përket kufijve të Kosovës.

"Është e rëndësishme që të arrihet një marrëveshje ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. SHBA-ja do të vlerësojë nëse një marrëveshje e tillë është në të mirën dhe stabilitetin e rajonit. Është një proces i hapur. Mendoj se është një moment i mirë dhe se ky problem duhet të zgjidhet njëherë e përgjithmonë, dhe pse jo tani?", ka përfunduar ambasadori i SHBA-ve/Expres/



## Budallallëqet e Koço Danaajt

"Danaaj prej së largu na thotë që mos ta votojmë referendumin, hajde, hajde si na çuditi Danaaj i Shqipërisë natyrore, ky mendon se vetëm natyrorët janë shqiptarë e aspak si shkon ndërmend se shqiptarët janë qiellor e shpirtëror, çfarë na duhet ajo Shqipëria e tij natyrore, me zvaranikë të llojeve të ndryshme, me minj, maca, "gjarpërinj" e "nepërka" pa shpirtin qiellor shqiptar. Gjuhën, kombin e historinë shqiptare s'kanë mundur të na humbin Perandoritë e ndryshme natyrore: Romake, Bizantine e Osmane e do na humb referendumi. Proçkullat dhe kopallat e Danaajt s'kanë të sosur.

Ju bre, zotëri Koço Danaaj, mos keni ndonjë forcë magjike e tët' dëgjojmë për mos votimin e referendumit e të na shpëtoni nga vdekja e gjuhës, kombit e historisë sonë?, a?, a mundeni t'iu kundërvihen BE-së e SHBA-së nëse s'votojmë referendumin? Mos vallë do përdorni sekretin tuaj magjik për të kundërshtuar pro-referendumin evropian e të Natos, mos?

Prandaj s'është mendje e mirë dhe e mençur kjo që thoni ju, përveç budallallëkut tuaj intelektual, politik e patriotik kurrëgjë tjetër", shkruan në profilin e tij në Facebook shkrintari dhe pedagogu Sulejman Mehazi.

## I dashur prind! Arsyeja pse fëmija është i paedukuar???

"Situatë shembull: fëmija është në park lojrash dhe bën gjithçka për të dal mbi të tjerët; i shtyn, ju bërtet dhe në fund ja del të ngjitet i pari. Prindi, ndërsa e sheh nga larg u thotë të tjerëve "shihni fëmijën tim, sa i shkathët!" I dashur prind! Jo, yt bir nuk është i shkathët, është i paedukuar dhe shkaku je TI! Ndërkaq, duke parë fëmijën e 'shkathët', një tjetër prind nxit fëmijën e tij të përparojë në lojë, në të njëjtën mënyrë! Kjo është shoqëria ku jetojmë! Bota e të 'shkathëve'! Nëse ti më del përpara atëherë do ta bëj edhe unë! Jo! Nuk duhet të funksionojë kështu! Nëse e lejon fëmijën të bëjë ato veprime në moshën 6 vjeçare, nëse e mbron kur nuk ka të drejtë, nëse qesh kur sillet keq, nëse e justifikon kur i përgjigjet keq një shoku, atëherë nuk di asgjë për edukimin e fëmijës! Nëse ti sillësh mirë, e ndihmon tjetrin, përsëritet njerëzit, ju buzëqesh, i falenderon, të jesh i sigurtë që edhe fëmija yt do bëjë të njëjtën gjë! Nëse përpiqesh t'ja ngulitësh këto norma vetëm me fjalë, pa i respektuar vetë, atëherë e ke të kotë! Duhet të jemi të kujdesshëm në gjithçka që themi. Nëse mësuesja nuk sillet mirë dhe ti do shkosh të përgjigjesh për fëmijën, nuk duhet ta bësh këtë në sy të tij! Ajo mund të jetë gabim por të gjitha këto biseda mos i bëni përpara fëmijës! Nëse ju e ulni figurën e mësuesit përpara fëmijës, automatikisht, e lejoni fëmijën të sillet si të dojë, me ta dhe me ju! Një tjetër gabim i rëndë që bëni, është që flisni keq për të tjerët në sy të fëmijëve! Mos u habitni nesër kur fëmija të bëjë të njëjtën gjë me ju!", shkruan në profilin e tij në Facebook diplomati Daim Iljazi.

## MEDIACitate



## Sallat diplomatike të Vuçiqit në Kosovë

Me fjalimin e tij në Kosovë, presidenti i Serbisë Aleksander Vučić, u tregua një lloj 'pale e tretë' në zgjidhjen e konfliktit të Kosovës. Ai bëri akrobacione diplomatike ndaj Bashkimit Evropian, me fjalën e tij në Kosovë, shkruan e përditshmja gjermane. Fjalimi i Vuçiqit në Kosovë dhe barrikadat kundër vizitës së tij, tregojnë se ende është shumë larg marrëveshja mes Beogradit dhe Prishtinës si dhe Vuçiq, me paraqitjen e tij në Kosovë, bëri një akrobacion diplomatik ndaj Bashkimit Evropian.

Vuçiqit iu dha 'një meritë kontraversale' dhe gjatë fundjavës, me vizitën e tij arriti të 'portretizojë një të vërtetë të hidhur: që konflikti me Kosovën është ende larg zgjidhjes'. "Si një strategjist tranzicional, Vuçiq duke folur publikisht për idenë e shkëmbimit të territoreve mes serbëve dhe shqiptarëve, ai arriti ta lejojë veten të 'fluturojë' sërish mbi Kosovë".

Me fjalimin e tij dhe me 'akrobacionin e tij diplomatik', Vuçiq për herë të parë foli par akterëve të Bashkimit Evropian se ka ndarje të thella lidhur me ndryshimin e kufijve, derisa Gjermania, në mënyrë të prerë kundërshton një ide të tillë duke e parë si një precedent të rrezikshëm, e deri san ë anën tjetër, kemi edhe zyrtarë nga Komisioni Evropian që nuk janë decidivisht kundër një ideje të tillë. "Kur të dy palët janë duke argumentuar, Vuçiq si palë e tretë, nuk ka nevojë të ketë frikë nga presioni i momentit. Ky është një sukses momental i tij, por është një goditje ndaj ndërmjetësuesve të Bashkimit Evropian".

(Süddeutsche Zeitung, 11 shtator)

## NËSE NUK E KENI DITUR...

## Zbardhet misteri i ndërtimit të piramidave

Shumë studiues menduan se "varret egjiptiane" u ndërtuan për të nxjerrë në pah madhësinë e faraonëve. Dhe kjo është ajo që kemi studiuar në shkollë. Po, koha e kaluar! Por duket sikur shkencëtarët më në fund kanë zbuluar qëllimin e vërtetë të piramidave! Duket se këto struktura unike mund të kenë pasur një funksion që ishte shumë larg nga varrosja e të vdekurve.

– Piramida e Madhe e Gizës është bërë me mbi 2 milionë bloqe guri, secila prej 3 deri 30 ton. Në fakt, ato më gjigande mund të jenë aq të rënda sa 50 ton! Baza e Piramidës së Madhe mbulon një sipërfaqe prej 592,000 metra katrorë dhe secila nga anët e saj është rreth 218,000 metra katrorë në madhësi.

– Nëse e lëshoni stereotipin se qytetërimet e lashta ishin më pak të zhvilluara se ne sot, lind një pyetje: a mund të kenë egjiptianët e lashtë teknologjitë më të avancuara si

ato moderne? Po sikur njohuria e tyre të humbiste vetëm për t'u rizbuluar shekuj më vonë?

– Në mënyrë interesante, egjiptianët përdorën gjithashtu një material të veçantë, dolomit, në anët e brendshme të piramidës. Ky mineral është i njohur për shumëzimin e përçueshmërisë elektrike.

– Teknologjia moderne ende nuk mund të rikrijojë llacin me bazë gipsi që është përdorur gjatë ndërtimit të piramidave. Ky lloj gipsi përballon sasi të mëdha presioni. Pra, kjo mund të tingëllojë e çuditshme, por fortësia që i mban ato është, në fakt, më e fortë se bloqet e vetë piramidës.

– Në vitin 1993, një dhomë sekrete e paarritshme u zbulua nën Piramidën e Madhe. Kjo dhomë, e cila dukej e fshehur qëllimisht, u quajt "Dhoma e Mbretëreshës". Në vitin 2011, në sajë të teknologjive më të zhvilluara, u bë e



mundur për të eksploruar dhomën me ndihmën e një aparati të largët.

– Në majë të Piramidës së Madhe të Gizës, kishte një gur të bërë tërësisht prej ari. Ai dërgoi një rrugë për të transferuar jonet negative (ato janë atome me një ngarkesë elektrike) në jonosferë (shtresa e atmosferës së tokës që përmban një ton atome). Dhe kështu u prodhua një rrymë elektrike me fuqi të madhe!

DILEMAT POLITIKE PARA REFERENDUMIT

# VMRO NUK DO TË THËRRET NË BOJKOT

Sipas burimeve anonime të afërta me VMRO-në, struktura udhëheqëse partiake ndonëse nuk do të bëjnë thirrje për bojkot por se nuk priten të dalin të votojnë as për opsionin kundër në referendum. Sipas këtyre burime ky do të jetë një bojkot i heshtur i shprehur në mënyrë indirekte nga strukturat partiake. Ndryshe nga Shtabi i krizës i përbërë prej 30 subjekte partiake dhe organizata joqeveritare të martën kanë qenë në pritje që VMRO të marrë vendim të prerë për bojkot të referendumit



kuptohet se kjo parti nuk do të marrë vendim konkret bojkot por se deri në fund do të kundërshtojë Marrëveshjen për emrin.

"Sot kryetari me kryesinë e ngushtë, kishte takim me grupin parlamentar, më vonë do të mbledhet Komiteti Drejtues dhe Komiteti Ekzekutiv dhe vetëm son-te vonë ose nesër mund të dimë qëndrimin e Partisë për referendumit. Ajo që mund të them tani është se marrëveshje për emrin me Greqinë është katastrofale dhe ne mbetemi në qëndrimin për ta kundërshtuar deri në fund. Por se çfarë do të vendosin organet më të larta partiake nuk mund të prej-dikoj prej tani", tha zëdhënësi partiak Dimçe Arsovski.

## BOJKOT I HESHTUR

Ndërkaq sipas burimeve anonime të afërta me VMRO-në strukturat udhëheqëse partiake ndonëse nuk do të bëjnë thirrje për bojkot por se nuk priten të dalin të

votojnë as për opsionin kundër në referendum. Sipas këtyre burime ky do të jetë një bojkot i heshtur i shprehur në mënyrë indirekte nga strukturat partiake. Ndryshe nga Shtabi i krizës i përbërë prej 30 subjekte partiake dhe organizata joqeveritare të martën kanë qenë në pritje që VMRO të marrë vendim të prerë për bojkot të referendumit siç thoin ata për ta gëzuar popullin me këtë vendim të drejtë. "Në këto momente të vështira për atdheun kur pushteti puçist në Shkup është në tentime dëshpëruese për të prishur gjithçka që është maqedonase, VMRO-DPMNE-ja të qëndrojë në anën e popullit të Maqedonisë, një pjesë e madhe e qytetarëve, maqedonasit jashtë vendit, të cilët nuk do të dalin në referendumin e ardhshëm se nuk dëshirojnë ndryshim të emrit shekullor të Maqedonisë", citohet në njoftim. Shtabi i krizës kundër referendumit dhe populli i Maqedonisë, citohet më tej, fuqi-

shëm besojnë se edhe VMRO-DPMNE-ja si parti demokristiane dhe me besim të plotë në Zot, e ndan gatishmërinë tonë të mbesim ata që jemi, të shkohet deri në fund në mbrojtjen e Maqedonisë dhe qytetarëve të Maqedonisë, nga qëllimi qartë i shprehur i pushtetit puçist në Shkup që t'i fshijë maqedonasi. Në këtë moment, thuhet në kumtesë, duhet të largohen mënjane interesat e ngushta-partiake dhe gjitha forcat nacionale dhe patriotike që në mënyrë të drejtë t'i sistemojnë interesat që nënkupton, nënë vend të parë interesin nacional dhe shtetëror, në vend të dytë interesin partiak dhe madje diku në vend të tretë interesin personal.

## LIDERËT POLITIK SHQIPTAR, MË AKTIV PRO REFERENDUMIT

Nga ana tjetër liderët politik shqiptar janë më se aktiv pro referendumit. Kryetari i PDSH-së Menduh Thaçi e quajti ngjarje të

madhe historike, kur veç tjerash siç shtoi Thaçi me anëtarësimin e Maqedonisë në NATO statusi i shqiptarëve në Maqedoni dukshëm do të përmirësohet. "Ky referendum është jashtëzakonisht i rëndësishëm për shqiptarët, tepër i rëndësishëm sa që më lejoni ta quaj historik. Unë nuk po marr mbi vetë si kryetar, as si parti meritat për betejat e mëdha historike që bashkarisht i kemi pasur. Vetëm dua ti përkujtoj skeptikët, dua ti përkujtoj dhe dembelët se kjo betejë është historike e shqiptarëve dhe kjo betejë po zgjat me shekuj e me shekuj. Çdo betejë e jona kombëtar jashtë rrugë së NATO-s dhe Unionit Evropian aspak nuk ka kuptim, deklaroi kryetari i PDSH-së Menduh Thaçi. Ai shtoi se PDSH historikisht ka qenë e pozicionuar pro vlerave që sjell NATO dhe BE dhe se ka punuar fort për to, kurse më integrimin në NATO do të përmirësohet dukshëm statusi i shqiptarëve në Maqedoni. "Apekti kombëtar, çështja e identitetit dhe e të drejtave juridike-kushtetuese shumë shpejtë do të përmirësohet. Në punojmë, insistojmë dhe jemi këmbëngulës në këtë drejtim", theksoi Menduh Thaçi. Partia më e madhe në pushte nga radhët e shqiptarëve BDI, të martën në mesditë kishte mbledhje të shtabit qendror më të gjah funksionarët shtetëror nga kjo parti, deputete, ministra, zëvendësministra, drejtor dhe kryetar komunash. Ministri i arsimit Arbër Ademi, tha për mediat se kjo mbledhje ka për qëllim të definojë agjendat partiake nëpër strukturat lokale. Asghjë nuk i lihet rastit, por të gjithë do të punojmë për një referendum të suksesshëm", tha mes terash Arbër Ademi.

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 11 shtator-Partia më e madhe opozitare VMRO-DPMNE me kryetar Hristijan Mickovskin mbetet në qëndrim të forta kundër Marrëveshjes për emrin me Greqinë. Sa i përket referendumit VMRO më së voni sot do të shpall qëndrimin përfundimtar pas analizave dhe diskutimeve të gjera brenda partiake. Por nga ajo që thotë për gazetën KOHA zëdhënësi i partisë Dimçe Arsovski, len të

# XHAFERI: BESOJ NË SUKSESIN E REFERENDUMIT

Shkup, 11 shtator - Besoj tek qytetarët, ashtu siç ata besuan në mua, në institucionet, në partitë që i mbështetën deri më tani dhe prandaj jam i bindur se në fund qytetarët do të reflektojnë me dalje, të domosdoshme për t'u zgjidhur çështja për emrin dhe përfundimisht të bëhemi anëtare e BE-së dhe e NATO-s, deklaroi në intervistë për MIA-n kryetari i Kuvendit, Talat Xhaferi.

Xhaferi thotë se qytetarët tanë janë të vetëdijshëm ta kuptojnë peshën dhe nevojën që personalisht ta thonë qëndrimin e vet në referendum dhe të ndërmarrin një pjesë të përgjegjësisë personale për të ardhmen e tyre individuale dhe për familjet e tyre në tërësi.



Kuvendi e filloi fushatën mediale për referendumin, ndërsa deputetët përmes Koalicionit "Për" referendumin flasin dhe kanë takime me qytetarë. Xhaferi për

MIA-n thotë se përfundimisht me ditën e djeshme, Parlamenti ka arritur 51 marrëveshje me televizione dhe radio për prezantim medial të deputetëve të cilët e

mbështesin çështjen e referendumit, ndërkaq gjatë ditës pritet që kjo të bëhet edhe me të tjerët. Marrëveshje arrihen, përkujton ai, me mediumet të cilat në afatin e

paraparë kanë parashtruar çmimore për prezantim medial për referendumin në KSHZ, ashtu siç është paraparë, për nëntë minuta në orë. Xhaferi sqaron se si do të zhvillohet fushata e deputetëve, por edhe si ai do të kyçet në të.

Në pritje të qëndrimin të VMRO-DPMNE-së opozitare për referendumin dhe kyçjen e mundshme të deputetëve të saj në fushatë, kryetari i Kuvendit thekson se "nëse ka, kurdo që të ketë vendim për t'u kyçur, mjetet janë në disponim", por potencioi se aktivitetet duhet të jenë pa ikonografi partiake dhe se ata do të mund të kyçen në atë pjesë mediale prej nëntë minutave në një orë.



## Wes Mitchell të enjten në Shkup

Ndihmësi i sekretarit shtetëror amerikan për Evropë dhe Euroazi, Wes Mitchell më 13 shtator do të vijë në Maqedoni në takime me kryeministrin e Maqedonisë Zoran Zaev dhe përfaqësues të tjerë zyrtarë për mbështetjen e marrëveshjes së Prespës midis Maqedonisë dhe Greqisë dhe referendumin e ardhshëm më 30 shtator, kumtoi Stejt Departamenti. Mitchell në Shkup do të ketë takime edhe me përfaqësues të partive parlamentare dhe të komunitetit të biznesit me të cilët do të shkëmbejnë mendime dhe do ta theksojë mbështetjen e Amerikës për inkuadrimin e Maqedonisë në familjen perëndimore, theksohet në kumtesë. Paraprakisht Mitchell do të qëndrojë në Gjeorgji ku do të marrë pjesë në Konferencën Ndërkombëtare në Tbilisi dhe do të ketë takime me përfaqësues të autoriteteve dhe të shoqërisë civile.

## Komitet i përbashkët i Maqedonisë dhe Greqisë për histori

Është formuar Komiteti ndërdisiplinor i përbashkët i ekspertëve mes Maqedonisë dhe Greqisë.

Nga Ministria e Jashtme njoftojnë se në përbërjen e Komitetit nga ana e Maqedonisë janë caktuar 7 anëtarë në krye me ambasadorin Viktor Gaber. Komiteti i përbashkët i ekspertëve është i vetmi detyrim i palëve, që duhet të funksionojë para hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Prespës.

Me Marrëveshjen e Prespës parashikohet që ky komitet për çështje historike, arkeologjike dhe arsimore të formohet 1 muaj pas nënshkrimit të marrëveshjes dhe i njëjti të bëjë revizionin e teksteve të historisë.



## ASHAM DEBATON PËR EMRIN

# KONFIRMOHET IDENTITETI DHE GJUHA MAQEDONASE

Nga ASHAM apeluan deri tek VMRO-DPMNE-ja opozitare dhe të gjithë ata të cilët do të deklarohen kundër ose do ta bojkotojnë referendumin t'i vlerësojnë qëndrimet e tyre dhe ta kuptojnë shansin historik i cili hapet me marrëveshjen



Shkup, 11 shtator- Konfirmim i identitetit të Maqedonisë dhe gjuhës maqedonase, hapje e dyerve për anëtarësim të plotfuqishëm të Maqedonisë në Bashkimin Evropian dhe në NATO, përmirësim i gjendjes ekonomike, përforsim i qeverisjes së të drejtës, stabilizim të rajonit janë një pjesë e përfitimëve të cilat vendi i ka me marrëveshjen e arritur me Greqinë për zgjidhjen e kontestit për emrin, këto janë konkludimet e pjesëmarrësve në pjesën e parë të debatit të sotëm shkencor të titulluar "Marrëveshja e Prespës: Rëndësia ndërkombëtare dhe implikimet ndaj integriteteve euroatlantike të Republikës së Maqedonisë". Ata me apel deri tek VMRO-DPMNE-ja opozitare dhe të gjithë ata të cilët do të deklarohen kundër ose do ta bojkotojnë referendumin t'i vlerësojnë qëndrimet e tyre dhe ta kuptojnë shansin historik i cili hapet me marrëveshjen. "Morëm nevojë të kristaltë dhe të qartë për gjuhën maqedonase dhe identitetin e Maqedonisë, maqedonas, maqedonas, maqedonase. Si në shtëpi, ashtu edhe jashtë vendit. E përkthyer pa kufizimet e të gjitha gjuhëve në botë, identitet për përdorim të përgjithshëm. Greqia e pranon identitetin tonë. Gjuha do të shfrytëzohet lirish gjithkund, në KB, në NATO, BE në të gjitha institucionet zyrtare, aktivitetet dhe ngjarjet", porositi kryeministri Zoran Zaev para pjesëmarrësve të pranishëm në pjesën e parë të debatit të titulluar "Konteksti ndërkombëtar dhe politik dhe rëndësia e Marrëveshjes". Në pjesën e parë të debatit u drejtua

edhe shefi i diplomacisë Nikolla Dimitrov, i cili theksoi se rruga përmes të cilës kemi ecur 27 vjet, përfundimisht u konfirmua me marrëveshjen e Prespës. Shtoi se vendi nuk mund të jetë pjesë e NATO-s dhe BE-së nëse nuk është mik me shtetet të cilat tashmë janë brenda këtyre institucioneve. "Kjo marrëveshje ka rëndësi të madhe historike sepse ne në të vërtetë për herë të parë pajtohemi si dy popuj. Marrëveshja është prodhim i negociatave të vështira. Madje nëse i ndryshojmë qoftë edhe dy presje do të këputet peri, mezi e kemi lidhur perin edhe nga ana jonë edhe nga ana e tyre. Pajtimet historike janë të vështira", tha Dimitrov. Theksoi se më në fund është gjetur dera përmes së cilës vendi do të shkojë përpara. "Me rëndësi është që përmes kësaj dera të hyjmë me kokën lart. Vlerësimet se doreza nuk shkëlqen sa duhet, se dera nuk është tre, por dy metra janë jokonstruktive dhe të papërgjegjshme. Nëse mund të gjejmë derë tjetër, më të gjerë dhe më shkëlqyese, le të na i tregojnë", tha Dimitrov. Shefi i diplomacisë potencoi se është koha të tejkalohen interesat personale dhe partiake dhe t'i jepet mundësi ardhmërisë së Maqedonisë. Ai u bëri thirrje anëtarëve dhe simpatizantëve të VMRO-DPMNE-së të mendojnë se çka do të thonë për ta katër shkronjat që i bartin për historinë e Maqedonisë.

Zëvendëskryeministri i obliguar për Çështje Evropiane, Bujar Osmani tha se Maqedonia është me të vërtetë Ballkani me pak fjalë dhe se vendi e ka gjetur formulën

si të jetë demokraci funksionale, multietnike dhe multireligjioze. Ai theksoi se bazat e kësaj shoqërie multietnike janë Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim dhe Marrëveshja e Ohrit, dy dokumentet e rëndësishme të nënshkruara në të njëjtin vit. "Ato bëhen lëndë djegëse për modelin, pasi janë komplementare dhe plotësohen", tha Osmani dhe shtoi se edhe krahas përparimit që vendi e realizon gjatë viteve të kaluara, lënda djegëse nuk ka arritur deri te motori, për shkak të kontestit të pazgjidhur për emrin me Greqinë. Kjo Qeveri, shtoi Osmani, ka përpunuar master plan që në afat prej një viti t'i lëvizë të gjitha proceset më të rëndësishme. Ai theksoi se gjatë negociatave, edhe pse ai është shqiptar, shpesh ka qenë në situatë që me pasion dhe përkushtim më të madh ta mbrojë identitetin dhe gjuhën maqedonase, ndërsa nga ana tjetër shpesh ka qenë dëshmitar se si kryeministri Zoran Zaev, megjithatë e ka mbrojtur edhe miratimin e ligjit për gjuhët. Para të pranishmëve fjalim mbajti edhe kryetari i parë i Kuvendit të RM-së, Stojan Andov, i cili theksoi se në vend ende ka rryma të cilat përhapin mendim negativ për NATO-n, si fuqi imperialiste, e cila i mbron interesat e SHBA-së. "Ka profesorë në fakultet, doktor të shkencave, të cilët punojnë që t'i bindin njerëzit që të mos dalin në referendum ose të votojnë kundër ratifikimit të marrëveshjes, por ata nuk ofrojnë asgjë, nuk ofrojnë alternativë me të cilin do të ndërrohet marrëveshja dhe për atë se

si do të funksionojë shteti. Po shfaqet ndarja e popullit të Maqedonisë. Kjo ndarje është e rrezikshme sepse është rezultat i politikës së izolimit nga vlerat perëndimore", tha Andov. Shtoi se kjo është politikë të cilën nga viti 2009 po e zbaton presidenti Gjorge Ivanov dhe dërgoi apel deri te VMRO-DPMNE-ja opozitare që të mos e gëlltitë goditjen e kursit të izolimit të Maqedonisë nga vlerat perëndimore.

Nga ana tjetër Akademia e Shkencave dhe Arteve e Maqedonisë do të ketë konsultime me ekspertë me qëllim që të konstatohet nëse ekziston mundësia për fleksibilitet më të madh lidhur me çështjen për riemërim të këtij institucioni në pajtim me dispozitat nga Marrëveshja e Prespës. Në nenin 1 të Marrëveshjes ceket se mbiemri lidhur me shtetin, organet e tij zyrtare dhe institucionet e tjera publike do të jetë në pajtim me emrin zyrtar të palës tjetër apo me emrin e vet të shkurtuar, përkatësisht "të Republikës së Maqedonisë Veriore" apo "të Maqedonisë Veriore". Përdorime të tjera të mbiemrit, përfshirë edhe përdorimin e mbiemrit lidhur me entitete private dhe aktorë, të cilët nuk janë të lidhura me shtetin dhe entitetet publike, që nuk janë themeluar me ligj dhe nuk marrin mbështetje financiare nga shteti, mund të jenë në pajtim me nenin 7. Akademiku Vllado Kambovski në bisedë me gazetarë pas përfundimit të pjesës së parë të debatit shkencor theksoi se në Marrëveshje definohet qartë se ku përdoret mbiemri.

PREZANTOHET DËSHMIA KYÇE E RASTIT "MONSTRA"

# PSE "OMEGA" U FSHEH GJASHTË VITE?

Fshehja e veturës "Opell Omega" si provë relevante në rastin "Monstra" u zbulua pas gjashtë viteve. Faktin se pse kjo veturë nuk i është prezantuar palës mbrojtëse dhe të akuzuarve nuk dëshironin ta komentojnë as nga Gjykata Penale e Shkupi dhe aq më pak nga Prokuroria Speciale Publike. Në seancat e radhës të caktuara për muajin tetor sipas të gjitha gjasave do të diskutohen edhe detajet lidhur me këtë dëshmi

Koha Omer XHAFERI

Shkup, 11 shtator - Gjashtë vite pas vrasjes së pesëfishtë në Liqenin e Smilkovës në Shkup, vetura e famshme "Opell Omega" e cilësuar si ndër dëshmitë kyçe në rasti "Monstra" të martën u prezantua para opinionit. Trupi gjykues i kryesuar nga gjykatësit Ognen Stavrev dhe Osman Shabani, prokurorët special Fatime Fetai dhe Gavril Bubevski, përfshi avokatët e të akuzuarve në rastin "Monstra" dhe një numër i konsiderueshëm i gazetarëve në njërin prej depove të Agjencionit për Konfiskim të Pronës patën rastin nga afër të shohin veturën (dëshminë) e cila deri më tani ishte e njohur vetëm për policinë.

Kontrolli dhe qasja mbi këtë veturë siç tha prokurorja speciale Fatime Fetai e demanton qëndrimin e palës mbrojtëse se vetura në pjesën e pasme nuk ka pasur ulëse, gjegjësisht në pjesën e pasme të gomave nuk ka pasur mbrojtje nga lloçi. Faktin se bëhet fjalë për ve-



## "OPELL OMEGA" PJESE E ALFA-ve?!

Në qershor të vitit 2013, dëshmitari i palës mbrojtëse Dime Veskov, para Gjykatës Penale të Shkupit, kishte deklaruar se vetura "Opell Omega" e prezantuar si dëshmi kundër të akuzuarve në rastin "Monstra" është automjet që e shfrytëzojnë pjesëtarët e njësisë policor "Alfa". Atë kohë dëshmitari Veskov kishte mbajtur dënimin me burg në Idrizovës për kryerjen e veprës penale "mashttrim". Lidhjen e tij me veturën "Opell Omega" ai e kishte ndërlidhur me arrestimin që pjesëtarët e njësisë "Alfa" e kishin bërë në vitin 2009-të. Transportimi drejt stacionit policor nga "Alfat" siç kishte thënë ai ishte realizuar pikërisht me këtë veturë, për të cilën në aktakuzën e rastit "Monstra" thuhet se vrasësit janë larguar nga Liqeni i Smilkovës. Mbetet të shihet se vallë në fazën e mëtejshme të procesit gjyqësor do të ftohet ky dëshmitar për të përsëritur deklaratën apo për të shtuar ndonjë detaj të ri.

turën e njëjtë të cilën deri më sot pala mbrojtëse e të akuzuarve në rastin "Monstra" e kishte parë vetëm në fotografi, e vërtetuan edhe avokatët Naser Raufi dhe Asmir Alispahiç. Megjithatë, dilema e cila duhet të sqarohet në proces gjyqësor është sepse kjo dëshmi është fshehur gjatë këtyre gjashtë viteve.

Në bazë të procesverbalit që e dispononte depoja e Agjencionit për Konfiskim të Pronës, vetura "Opell Omega", në magazinën e Milladinovcit ishte pranuar me 1 nëntor të vitit 2012. Paraprakisht ajo ishte nënshkruar ekspertizë nga ana e policisë së shtetit. Pas hapjes

së veturës të martën dhe vëzhgimit të detajuar nga opinionit aty u gjetë një çantë dhe dy monedha të hekurta. Ngjashëm si Prokuroria

për krim të organizuar, ashtu edhe Prokuroria Speciale Publike deri më i qëndron prapa aktakuzës së më këtë veturë nga vendi i ngjarjes

## MUNGOJNË DETAJET NGA "BOMBAT" E ZAEVIT!

"Bombat" për vrasjen në Liqenin e Smilkovës, të cilët vite më parë kryeministri aktual Zoran Zaev i kategorizoi si materiale të cilët mund të shkaktojnë trazira dhe për këtë shkaqe nuk i publikoi, tashmë e një kohë të gjatë i disponon PSP. Njohësit e zhvillimeve në gjyqësor jo zyrtarisht flasin se ndryshimi i aktakuzës në rastin "Monstra" gjithsesi se do të ndodhë. Mirëpo mbetet të shihet se kush do të përfshihet në aktakuzën e re të PSP dhe vallë të akuzuarit e deritashme do të lirohen nga aktakuza ose ndaj të njëjtëve do të ngritën akuzë të reja.

Miratimi i Ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve ishte njëra prej arsye kryesor të cilët prokurorja speciale Katica Janeva vazhdimisht e përsëritte se paraqet pengesë se pse ato nuk mundet ta marrin përsipër lëndën për "Monstrën". Por, pavarësisht se ndryshimet e këtij ligjit kanë kaluar në parlament në prill të këtij viti, deri më sot PSP nuk ka dhënë asnjë detaj më të vogël për përmbajtjen e "bombave" të dorëzuara nga Zaevi apo se konform Ligjit të ri për mbrojtjen e dëshmitarëve është siguruar ndonjë dëshmitar i ri i mbrojtur në këtë rast.

## BE do të hapë programet Twinning dhe TAIEX

Ministri për Vetëqeverisje Lokale Suhejl Fazliu, sot në Shkup hapi takimin e 15-të Komitetit të përbashkët konsultativ të Republikës së Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian, në kuadër të Komitetit të Regjioneve të BE-së.

Në fjalën e tij, ministri Fazliu tha se ky takim mbahet në një moment shumë të rëndësishëm për Republikën e Maqedonisë, në të cilën qeveria është plotësisht e përkushtuar për procesin e integritetit dhe anëtarësimin në Bashkimin Evropian dhe në NATO.

"Besoj se referendumi do të jetë veprim i qartë i shprehjes demokratike të vullnetit të qytetarëve, me çka do të konfirmojmë se perspektivën tonë e shohim në Bashkimin Evropian dhe në NATO, duke mbështetur dhe duke i ndërtuar vlerat dhe politikën e përbashkëta", tha Fazliu.

Ministri Fazliu theksoi rolin e autoriteteve lokale në Republikën e Maqedonisë në procesin e integritetit në Bashkimin Evropian.

"Qytetarët të identifikojnë mundësitë për zhvillim dhe të

mbështesin vlerat euroatlantike, të vazhdojnë reformat dhe decentralizimin, rritjen ekonomike dhe garancat për jetë më të mirë, tha Jakob.

Ai bëri të ditur se në të ardhmen Bashkimi Evropian do të hapë programet Twinning dhe TAIEX dhe do të sigurojë mbështetje financiare për të forcuar kapacitetet e administratës lokale për menaxhim më të mirë dhe përgatitjen e projekteve për periudhën e ardhshme programore IPA 3", tha Franco Jakob.



deri në vendin "Vrazhimir" është vozitur i akuzuari në arrati Halil Demiri, i cili ngarkohet si njëri prej ekzekutorëve të veprës. Përsëritja e kësaj procedurë vijon pasi që lënda për rastin "Monstra" me vendim të Gjykatës Supreme të Maqedonisë vitin e kaluar u kthye në shkallë të parë. Mos prezantimi i këtyre dëshmiave palës mbrojtëse dhe të akuzuarve, si një dhe varg shkellesh tjerash procedurale ishin baza kryesore në të cilën Këshilli Penale i Gjykatës Supreme e mbështeti vendimin e saj për shfuqizimin të vendimeve paraprake të Gjykatës Penale të Shkupit dhe asaj të Apelit. Debatimi dhe pyetjet për kredibilitetin e dëshmiave kundër të akuzuarve Halil Demiri (në arrati), Afrim Ismailloviq (në arrati), Agim Ismailloviq, Fejzi Haziri (në burg për armë mbajtje pa leje), Haki Aziri dhe Sami Luta pritet të vazhdoi në njërin prej seancave gjyqësore që do të zhvillohen në tetor. Rigjykimi i rastin "Monstra" deri më sot përveç prezantimit të veturës "Opell Omega" nuk ka shpalosur asnjë detaj të ri për opinionin. Ndryshe, pasi PSP e mori përsipër shqyrtimin e rastin "Monstra" i gjithë opinionin ishte në pritje se e njëjta do të veprojë në mënyrë të njëjtë si në rastin e "Sopotit" ku u tërhoq aktakuza. Megjithatë, pas një sërë seancash gjyqësore deri më tani prokuroria e Katica Janevës vazhdon të qëndrojë në aktakuzën e ngritur nga prokurorja kontroverze Gordana Geshkovska.

Në bazë të hulumtimit të bëra nga e IHSE në pesë Universitete shtetërore dhe private në Maqedoni, nga të dhënat e studentëve erdhën në përfundim që forma më e zakonshme e korrupsionit është kushtëzimi i studentëve për blerjen e librave të profesorëve për të kaluar provimin apo për notë më të madhe. Mirëpo në shumicën e rasteve studentët janë të frikësuar ti paraqesin këto raste

Koha

Remzije Bilalli

Shkup, 11 shtator - Në Universitetin e Evropës Juglindore u mbajt Konferenca Ndërkombëtare me temën korrupsion në arsimin e lartë si pjesë e projektit "Universitete pa korrupsion" në organizim të Institutit për hulumtime strategjike dhe edukim (IHSE) dhe mbështetjen e SHBA në Maqedoni. Pjesëmarrës në këtë konferencë ishin profesorë universitar nga Maqedonia, Shqipëria, Kroacia, Italia, Serbia, Britania dhe Amerika të cilët tregun shkaqet e korrupsionit në sferën e arsimit në Maqedoni. Korrupsioni në arsim sipas profesorëve pjesëmarrës dhe hulumtimeve të bëra është si rezultat i ekonomisë, traditës, standardeve jetësore dhe politikës.

Për Gazetën KOHA, Aleksandra Denoska Trendafilova nga Fakulteti i Juridikut "Justiniani i Parë" i Shkupit deklaroi se ky projekt ka filluar me nënshkrimin e një deklarate nga ana e universiteteve shtetërore dhe disa private në kuadër të projektit "Universitete pa korrupsion" ku ishin paraparë një numër i madh aktivitetesh me studentët dhe profesorët.

KORRUPSIONI NË ARSIMIN E LARTË

# STUDENTËT FRIKËSOHEN T'I DENONCOJNË PROFESORËT



"Bëhet fjalë për një projekt ku janë të përfshirë një numër i madh aktivitetesh dhe trajnime në lidhje me zbatimin e ligjit për mbrojtjen e informatorit se si ai mund të jetë i veshëm për zbulimin dhe detektimin e korrupsionit pikërisht në sferën e arsimit. Mirëpo është kënaqësi pasi që një numër i universiteteve këtë e kanë zbatuar duke i publikuar materiale për studentët në mënyrë që ata ti mbrojnë të drejtat e tyre dhe të jenë në dijeni për të drejtat e tyre", tha Trendafilova.

Në bazë të hulumtimit të bëra nga e IHSE në pesë Universitete shtetërore dhe private në Maqedoni, nga të dhënat e studentëve erdhën në përfundim që forma më e zakonshme e korrupsionit është kushtëzimi i studentëve për blerjen e librave të profesorëve për të kaluar provimin apo për notë

më të madhe. Mirëpo në shumicën e rasteve studentët janë të frikësuar ti paraqesin këto raste.

"Kemi forma të ndryshme të korrupsionit si dhënia e parave, dhuratave dhe të tjera, por më e evidente është nëpërmjet shites së librave të tyre. Te gjithë këto mënyra kërkojnë tretman të veçantë sidomos me zbatimin e ligjit për mbrojtjen e informatorëve. Për shkak frikës nga pasojat që mund ti kenë studentët hezitojnë ti para-

qesin rastet e tilla. Shumica e punëve vetëm se janë të dukshme në universitete ngjashëm sikurse me shitjen e librave mirëpo duhet të kemi reagim më të ashpër", deklaroi profesora universitare Besa Arifi.

Me nënshkrimin e deklaratës në muajin dhjetorë ishte paraparë që në çdo universitet të ketë institucion dhe individ përkatës ku do të mund të paraqiteshin rastet e korrupsionit. Numri i studentëve

që besojnë se në universitetin ku studiojnë ka korrupsion është më i madh se 20 për qind. Në bazë të anketës të bërë nga IHSE në fillim një numër i madh i studentëve nuk ishin në dijeni se ekziston një ligj i tillë për mbrojtjen e tyre nga korrupsioni.

"Duhet të merren masa preventive që të bëhet parandalimi i këtyre dukurive me formimin e institucioneve përkatëse nëpër universitete ku studentët mund ti paraqesin rastet e korrupsionit, mirëpo nuk është vetëm tek formimi i këtyre institucioneve sepse duhet të krijohet besueshmëri e studentëve dhe personave të tjerë ndaj këtyre institucioneve që pa frik ti raportojnë rastet që kanë të bëjnë me korrupsionin në arsim. Nota e korrupsionit është në nivelin e perceptimit sepse shumica e studentëve tregojnë numra të ngjashëm në të gjitha universitetet ku është bërë hulumtimi", tha Arifi.

Mes tjerash Arifi shtoi se ndonjëherë studentët vendosin të zgjedhin mënyrën më të lehtë duke kryer një veprim të pa lejuar për të arritur qëllimin e tyre.

## SHQIPËRI, VETINGU EDHE NË SFERËN E ARSIMIT

**Profesorët universitar nga shtetet fqinje thanë se edhe atje po punohet për parandalimin e korrupsionit në fushën e arsimit. Për KOH-ën profesori universitar Alban Koci tha se në Shqipëri do të instalohet sistemi i Vetingut edhe në sferën e arsimit, mirëpo tani ekziston klasifikimi i universiteteve në bazë të asaj se**

**kush është më shumë e kush më pak i korruptuar. Mekanizëm për parandalimin e këtyre dukurive mbetet depolitizimi i institucioneve arsimore, zhvillimi i ekonomisë, ngritja e vetëdijes dhe instalimi i institucioneve për paraqitjen e aferave të korrupsionit.**

## Ministri Bekteshi vizitoi kompaninë "Dauti Komerc"

Ministri i Ekonomisë Kreshnik Bekteshi të martën ka vizituar kompaninë Dauti Komerc, si njëra nga kompanitë më të shëndosha dhe më të afirmuara në vend dhe më gjërë për tu njohur nga afër me kushtet, procesin e punës dhe gjithë ato veprimtari që i ofron kjo kompani konsumatorit.

Ashtu siç e dini edhe ju z. Dauti ka përvojë të madhe në biznes dhe nga afër e informova për shirjen e Ministrisë së Ekonomisë në realizimin e projekteve dhe programeve ekonomike në vendin tonë, ku si segment më i rëndësishëm është zbatimi i masave nga Planit për Rritje Ekonomike. Dhe një nga synimet për nxitjen e investimeve është që kompanive të vendit tu jepet mundësia për të inkuorporuar teknologji të reja në proceset e tyre të prodhimit dhe për të ndërtaur



kapacitete për zhvillimin e marrëdhënieve të biznesit me kompanitë e huaja, si dhe depërmin e prodhimeve të tyre në tregje sa më të mëdha ka theksuar Bekteshi.

DAUTI Komerc në punën e saj shumë vjeçare si biznes familjar, i plotëson të gjitha standardet e një kompanie serioze e cila falë rezul-

tateve të deritanishme të cilat i kanë treguar në treg si në vend ashtu edhe jashtë ka ndikuar dukshëm në klimën e biznesit tek ne që besoj dhe shpresoj të ndiqet edhe nga të tjerët sepse parametrat e suksesshëm të këtyre kompanive nënkuptojnë rritje ekonomike dhe sukses për ekonominë tonë u shpreh me këtë rast Bekteshi.

Njëri nga pronarët e DAUTI Komerc, Xhemali Dauti, falënderoi për vizitën Ministrin e Ekonomisë dhe për krahen morale që në vazhdimësi e ka pasur nga Ministria e Ekonomisë nga fakti se kjo kompani tre herë ka marrë mirënjohje si Kompani me përgjegjësi më të mira Shoqërore dhe se kjo mbështetje do të vazhdojë edhe më-

tutje si motiv shtytës për pushtimin e tregjeve me përmasa edhe më të mëdha.

Në takimin e pronarët e kompanisë Dauti Komerc I pranishëm ishte edhe kryetari I Komunës së Sarajit i cili me këtë rast tha se qelës i çdo suksesi padyshim se është puna me përkushtim, e cila më pas rezulton me përforsimin e kompanive në tregjet e njohura në rajon dhe më gjërë. Bekteshi me këtë rast edhe njëherë u ka bërë apel kompanive tona që në mënyrë aktive ti ndjekin thirrjet publike për masat që janë pjesë e programit qeveritar për rritje ekonomike dhe të mos ngurojnë, por të aplikojnë në bazë të kushteve sepse në këtë mënyrë kontribuohet për lehtësimin e biznesit, rritjen ekonomike dhe standard më të mire për të gjithë qytetarët.

Ekspertët e ushqimit pajtohen se konsumatorët vetë duhet të vendosin se a do të përdorin apo jo ushqimin GMO, por me kusht që të dinë se a është i trajtuar gjenetikisht. Në Maqedoni, sipas ekspertëve, nevojitet një vëmendje më e madhe ti kushtohet mbrojtjes së konsumatorëve

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 11 shtator - Në Maqedoni aktualisht nuk lejohet as prodhimi dhe as importi i ushqimeve gjenetikisht të modifikuara. Nga ana tjetër, në Bashkimin Evropian, ai lejohet në qarkullim, por vetëm me kusht që të jetë i shënuar duke i lënë konsumatorit të blejë apo të refuzojë konsumin e tij. Në nivel botëror opinioni shkencor është i ndarë lidhur me përdorimin e ushqimit GMO për qytetarët. Një grup thonë se pa prezencën e kontrolluar në aspekt shkencor tek drithërat e llojeve të ndryshme të GMO apo ushqimit të trajtuar gjenetikisht, bota do të mbetet e uritur. Pjesa tjetër e shkencëtarëve pohojnë se ai ka pasoja të dëmshme për shëndetin e njeriut. Ekspertët e ushqimit megjithatë pajtohen se konsumatorët vetë duhet të vendosin se a do të përdorin apo jo ushqimin GMO, por me kusht që të dinë se a është i trajtuar gjenetikisht ushqimin që konsumojnë.

Nga ana tjetër, ekspertët e ushqimit në Maqedoni, thonë se nevojitet që një vëmendje më e madhe ti kushtohet mbrojtjes së konsumatorëve.

"Nevojitet që institucionet në Maqedoni të kryejnë punën e tyre lidhur me kontrollin e rreptë të këtij lloj ushqimi. Me fjalë të tjera i

## DEBAT RRETH USHQIMIT GMO

# KONTROLLI - MBI TË GJITHA



tërë problem me GMO ushqimin në Maqedoni qëndron vetëm te mbrojtja e konsumatorëve", theksoi profesori universitar, Srećko Gjeorgjevski në kuadër të debatit në Odën Ekonomike të Maqedonisë, për nevojën apo jo të ndryshimit të ligjit ekzistues për shitjen e ushqimit GMO.

Nga ana tjetër, Mariana Llonçar Vellkova thotë se nevojitet që të avancohet rregullativa ekzistuese me qëllim që të jetë më lehtë e zbatueshme si dhe të rritet informimi i konsumatorëve lidhur me këtë ushqim.

"Kërkojmë të dimë se çka blejmë, që nënkupton etiketa të qarta me të gjitha informacionet e nevojshme. Njëherazi nuk duhet të manipulohet dhe të fshihet përmbajtja e prodhimit. Prodhimet duhet të përmbajnë të gjitha informacionet për GMO dhe elementet e tjera të rrezikshme kimike dhe të tjera për shëndetin e njeriut. Gjithashtu duhet të përmirësohen edhe ligjet, në favor të mbrojtjes së konsumatorëve", thekson Llonçar.

### USHQIMI GMO NËN MONITORIM TË RREPT

Numri i njëj Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë në Maqedoni, Zoran Atanasov thotë se konform legjislacionit aktual në vend as nuk prodhohet, por as nuk qarkullohet ushqim me përmbajtje të GMO, që sipas tij e dëshmojnë edhe monitorimet e rregullta të organeve kompetente. Megjithatë, dikasteri që ai drejton ka dorëzuar deri në qeveri propozim rregulloren që parashikon edhe kufirin e tolerancës prej 0.9 për qind së prezencës së GMO në ushqim. Në këtë mënyrë do të harmonizohet edhe legjislacionin vendor me atë evropian lidhur me këtë çështje. Nga qeveria nuk prononcohen se a do të ketë ndryshime të ligjit duke ndjekur shembujt evropian. Nga atje shtojnë se shëndeti i qytetarëve, por edhe plotësimi i standardeve evropiane mbeten prioritetet e tyre.

Në Maqedoni deri në vitin 2013 në Maqedoni lejohej shitja dhe prodhimi i ushqimit gjenetikisht të modifikuar, ndërsa me ndryshimin

e legjislacionit para pesë vitesh, si shtet u përcaktua si për zero tolerancë ndaj GMO.

Në ndërkohë, drejtori i AUV, Atanasov mbështet qëndrimin se ky lloj ushqimi nuk është i dëmshëm për shëndetin e njeriut. Ai shton se edhe në nivel evropian nga agjencitë kompetente të ushqimit, deri tani nuk janë konstatuar raste të rrezikimit të shëndetit nga konsumi i ushqimit GMO.

Ndryshe, ushqimi i prodhuar me përdorimin e GMO, njihet si ushqim i modifikuar gjenetikisht. Industria ushqimore në botë dhe ithtarët e GMO thonë se qëllimi i prodhimit të saj është që të fitohet prodhim me çmim më të ulët, me afat përdorimi më të gjatë ose me vlera më të mëdha ushqyese. Procesi ka filluar nga prodhues të farave GMO që ka pasur për qëllim që farat e tyre të jenë më të pranueshme nga prodhuesit, dhe janë orientuar drejt zbulimeve të cilat mundësojnë rendimente më të larta dhe profit më të madh për fermerët. Një nga qëllimet e zhvillimit të bimëve mbi bazë të GMO

është të përmirësohet mbrojtja e bimëve nga sëmundjet, duke u mundësuar bimëve rezistencë më të madhe ndaj sëmundjeve të shkaktuara nga insektet, viruset ose duke e zmadhuar tolerancën e tyre ndaj herbicideve.

### NUK JANË VËRTETUAR EFEKTE ALERGJIKE

Analizat e Institutit për Shëndet Publik të Maqedonisë, tregojnë se nga ana e Organizatës botërore të shëndetësisë dhe agjencisë së OKB-së për ushqim, FAO janë zhvilluar protokolle ose udhëzues për vlerësimin e vetive alergjene të llojeve të reja të bimëve të cilat përmbajnë GMO, ndërsa ushqimi i zhvilluar me metoda tradicionale për kultivim nuk testohet për alergjenë. Vlerësimi i këtyre analizave ka treguar se deri më tani nuk janë vërtetuar efekte alergjike tek ky lloj ushqimi i cili po shitet për momentin. GMO që për momentin tregtohet në tregjet ndërkombëtare i ka kaluar të gjitha vlerësimet e sigurisë dhe nuk do duhej të paraqiste rrezik për shëndetin e njeriut. Përveç kësaj, konsumimi i GMO nga popullata e gjerë në vendet ku ato janë të miratuara, ka treguar se nuk ka efekte ndaj shëndetit të njeriut. Trajtimi i GMO në botë rregullohet në mënyrë të ndryshme. Në disa shtet mungon një rregullore, ndërsa shtetet të cilat kanë legjislacion, fokusohen fillimisht tek rreziqet ndaj shëndetit të konsumatorëve. Gjithashtu, shtetet që kanë dispozita për rregullimin e kësaj materie, gjithashtu e bëjnë rregullimin e GMO në përgjithësi, duke i marrë parasysh rreziqet ndaj shëndetit të njeriut dhe mjedisit jetësor, si dhe çështjet që kanë të bëjnë me kontrollimin dhe tregtimin, siç janë analizat laboratorike dhe etiketimi. Në vendet e BE tregtimi i GMO është i lejuar, por nëse përbën 1 për qind ose më shumë të produktit, atëherë kjo gjë duhet të jetë e shënuar te deklarata ku do thuhet se ushqimi përmban GMO.

Tek ne është përshtypja se autizmi vjen nga vaksinat, por edhe në shtetet e zhvilluara ka autizëm, kështu që shumë teori bien në "ujë", thotë gjinekologu Jakupi. Sipas tij aktualisht punohet në qelizat amë, për shërimin e autizmit

Koha Delvina KËRLUKU

Shkup, 11 shtator - Nuk ka shkaqe të qarta për autizmin, por fatkeqësisht vitet e fundit numri i të prekurve, sipas ekspertëve të fushës, ka pësuar rritje shqetësuese. Fëmijët e prekur nga ky çrregullim që jetojnë në vendin tone nuk marrin shërbimet shëndetësore të duhura, për shkak të kostos së lartë dhe

## Autizmi, problem i pazgjidhshëm në shoqëri

në mjaft raste edhe për arsye të stigmës, paragjyqimeve. Janë bërë shumë studime për gjetjen e shkakut të autizmit, por edhe zgjidhjen e së njëjtës. Mjekët dhe ekspertët e autizmit mendojnë që faktorët gjenetik mund jenë disa nga shkaktarët e kësaj sëmundjeje. Por, edhe faktorë tjerë ambiental që bëjnë trurin e fëmijës të zhvillohet ndryshe.

Ekspertët bëjnë të ditur që një listë kemikalesh dyshohet që ndikon në shkaqet e autizmit. Një studim i fundit nga Instituti Karolinska në Stokholm kanë zbuluar se diagnoza e sindromës "policistike të vezoreve" kur nëna rrit rrezikun e autizmit tek pasardhësi. Gjinekologu, Agim Jakupi, për gazetën KOHA thotë se vitet e fundit është rritur numri i fëmijëve autik,

dhe se dikur kjo sindromë është trajtuar si ndonjë sëmundje krejtësisht tjetër, e cila nuk ka hyrë në studimet mjekësore, por i përkiste pjesës së logopedëve. Ai shton se janë bërë shumë studime, por ajo që preokupon prindërit e fëmijëve autik janë vaksinat, gjë që është e gabueshme.

"Një studim i i fundit që thotë se autizmi vjen për shkak të problemeve të nënës nga sindroma e cila quhet "policistika e vezoreve", nuk mund të jetë arsye, sepse janë shumë faktorë që mund ta sjellin autizmin. Për autizmin nuk kemi akoma rezultate se është si shkak i ndotjes, kontaminimit të nënës gjatë shtatzanisë me ndonjë metal. Tek ne është përshtypja se autizmi vjen nga vaksinat, por edhe në shtetet e zhvilluara ka autizëm,

kështu që shumë teori bien në "ujë", thotë gjinekologu Jakupi. Sipas tij aktualisht punohet në qelizat amë, për shërimin e autizmit.

Logopedia Ana Petreska, për gazetën KOHA flet se arsyet pse ka një rritje të autizmit mund të jenë të shumta të tilla si lindjet e fëmijës nga metodat cezariane, që edhe shkakton shumë probleme si në shëndetin e nënës dhe te fëmija. Ndërsa nga aspekti defektologjik dhe logopedisë Petreska thotë se punohet për përmirësimin e gjendjes së fëmijës në shqiptimin e fjalës, që fëmija të komunikojnë me rrethin ku jeton, dhe në mënyrë të pavarur të përmbushin nevojat e tyre.

Logopedi Ermond Miftari për gazetën KOHA tregon se kohët e fundit është rrit numri i fëmijëve

autik, por nuk do të thotë se çdo fëmijë është autik nëse ai nuk di të flas edhe pse ka moshën 3, 4 vjeçare.

Ndryshe, Republika e zyrtarisht janë të regjistruar 170, por supozohet se numri është shumë më i madh. Sipas vlerësimeve nëse në Maqedoni ka 2.040.000 banorë të paktën duhet të ketë rreth 14.000 persona që janë në spektrin autik. Autizmi ka një normë rritjeje prej 10-17% në vit. Sipas një studimi që është realizuar në vitin 2016 i kryer nga Avokati i Popullit në disa qytete të Maqedonisë, 93 fëmijë me autizëm prej të cilëve 68 meshkuj dhe 25 fëmijë, ndjekin shkollën fillore, mirëpo vetëm një numër i vogël prej shkollave kanë ekip profesional për të punuar me fëmijët me autizëm.

REPUBLIKA E MAQEDONISË  
KOMUNA BOGDANCI



**SHPALLJE numër 1**  
**Për tjetërsim të tokës ndërtimore pronë e Republikës së Maqedonisë**  
**përmes ankandit publik elektronik në Komunën Bogdanci**

**LËNDË E ANKANDIT PUBLIK ELEKTRONIK**

Lëndë e ankandit publik elektronik është tokë e pandërtuar ndërtimore, pronë e Republikës së Maqedonisë, e paraparë me: 1. Plan urbanistik jashtë vendbanimit Bogdanci, lokaliteti Barta, për qëllim G2, G3, G4 – prodhim, distribim dhe shërbime – zona industriale, Komuna Bogdanci, të sjellë me Vendimin e Këshillit të komunës Bogdanci numër nr. 08-1843/31 të datës 30.11.2016 dhe nr. 08-2018/17 të datës 29.12.2016 dhe Korrigjimit nr. 08-163/2 të datës 30.01.2017 me qëllim ndërtimi: G2 – industri të lehtë dhe jondotëse me klasa kompatible të qëllimit B1, B2, B4, D2, D3 dhe D4 në pajtim me Pasqyrën tabelore nr. 1 në të cilin janë dhënë të dhëna për parcelën ndërtimore, qëllimi i parcelës, parcelat katastrale që janë të përfshira me parcelën ndërtimore, sipërfaqja e përgjithshme e parcelës ndërtimore, sipërfaqja për ndërtim në m2, bruto sipërfaqja e zhvilluar në m2, lartësia maksimale, katet, përqindja e ndërtimit (%), koeficienti i përdorimit, çmimi fillestar për m2, çmimi i përgjithshëm fillestar dhe garancia bankare për seriozitet të ofertës.

**Pasqyra tabelore nr. 1**

Numri rendor	Numri i parcelës ndërtimore	Klasa themelore e qëllimit të parcelës ndërtimore	Klasa kompatible e qëllimit	Numri i parcelës katastrale (KK Bogdanci dhe KK Bogdanci jash.v.n)	Sipërfaqja e parcelës ndërtimore (m²)	Sipërfaqja për ndërtim në (m²)	Bruto sipërfaqja e zhvilluar në (m²)	Lartësia maksimale deri në varg (m) dhe katet	Përqindja e ndërtimit (%)	Koeficienti i shfrytëzimit	Çmimi fillestar për m² (denarë)	Çmimi i përgjithshëm fillestar (denarë)	Garancia bankare për seriozitet të ofertës
1.1	P.N nr. 4	G2(industri të lehtë dhe jondotëse)	B1, B2, B4, D2, D3 dhe D4	PK nr. 11770/10, 11770/11 KK Bogdanci dhe 5079/7, 5079/4, 5079/19 dhe 5079/20 KK Bogdanci jash.v.n	3073	1464	2928	Sipas PAU /P +2	47,64	0,95	61,00	187.453,00	374.906,00
2.1	P.N nr. 5	G2(industri të lehtë dhe jondotëse)	B1, B2, B4, D2, D3 dhe D4	PK nr.11770/12,11770/13, KK Bogdanci dhe PK nr. 5079/5, 5079/41, 5079/8 и 5079/22 KK Bogdanci jash.v.n	3121	1430	2860	Sipas PAU /P +2	45,75	0,91	61,00	190.381,00	380.762,00
3.1	P.N nr. 6	G2(industri të lehtë dhe jondotëse)	B1, B2, B4, D2, D3 dhe D4	PK nr.11770/14, 11770/15,11769/3 KK Bogdanci dhe PK 5079/6,5079/9 и 5079/24 KK Bogdanci jash.v.n	3233	1449	2898	Sipas PAU /P +2	44,82	0,90	61,00	197.213,00	394.426,00
4.1	P.N nr. 7	G2(industri të lehtë dhe jondotëse)	B1, B2, B4, D2, D3 dhe D4	PK nr.5079/25 KK Bogdanci jash.v.n	1931	1145	2290	Sipas PAU /P +2	59,30	1,19	61,00	117.791,00	235.582,00
5.1	P.N nr. 8	G2(industri të lehtë dhe jondotëse)	B1, B2, B4, D2, D3 dhe D4	PK nr.5079/26 KK Bogdanci jash.v.n	1775	1040	2080	Sipas PAU /P +2	58,59	1,17	61,00	108.275,00	216.550,00
6.1	P.N nr. 10	G2(industri të lehtë dhe jondotëse)	B1, B2, B4, D2, D3 dhe D4	PK nr.5079/27 KK Bogdanci jash.v.n	4557	3190	6380	Sipas PAU /P +2	70	1,40	61,00	277.977,00	555.954,00
7.1	P.N nr. 11	G2(industri të lehtë dhe jondotëse)	B1, B2, B4, D2, D3 и D4	PK nr.5079/28 KK Bogdanci jash.v.n	3977	2780	5560	Sipas PAU /P +2	69,90	1,40	61,00	242.597,00	485.194,00
8.1	P.N nr. 12	G2(industri të lehtë dhe jondotëse)	B1, B2, B4, D2, D3 dhe D4	PK nr. 5079/30 и 5079/31 KK Bogdanci jash.v.n	2930	1876	3752	Sipas PAU /P +2	64,03	1,28	61,00	178.730,00	357.460,00
9.1	P.N nr. 13	G2(industri të lehtë dhe jondotëse)	B1, B2, B4, D2, D3 dhe D4	PK nr.5079/32 dhe 5079/33 KK Bogdanci jash.v.n	2800	1770	3540	Sipas PAU /P +2	63,21	1,26	61,00	170.800,00	341.600,00
10.1	P.N nr. 14	G2(industri të lehtë dhe jondotëse)	B1, B2, B4, D2, D3 dhe D4	PK nr.5079/34 dhe PK nr. 5079/35 KK Bogdanci jash.v.n	2742	1728	3456	Sipas PAU /P +2	63,02	1,26	61,00	167.262,00	334.524,00

**TË DREJTË PËR PJSËMARRJE**

Të drejtë për pjesëmarrje në ankandin publik kanë:

1. Personat fizik: shtetas të Republikës së Maqedonisë, shtetas të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe të OECD si dhe shtetas të shteteve të cilat nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian dhe OECD ndërsa me kusht të reciprocitetit mund të fitojnë të drejtën e pronësisë të tokës ndërtimore në territorin e Republikës së Maqedonisë.

2. Personat juridik: person juridik lokal, person juridik në pronësi të përzier, person juridik të themeluar nga personi fizik dhe juridik i huaj, të regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë, persona juridik të huaj rezidentë të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe të OECD si dhe persona juridik të huaj rezidentë të shteteve të cilat nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian dhe OECD ndërsa të cilët me kusht të reciprocitetit mund të fitojnë të drejtën e pronësisë të tokës ndërtimore në territor të Republikës së Maqedonisë.

**KUSHTET PËR PJSËMARRJE NË ANKANDIN PUBLIK ELEKTRONIK**

Personat e interesuar fizik dhe juridik dorëzojnë fletëparaqitje për pjesëmarrje në ankandin publik (në formë elektronike në internet faqen [www.gradezno-zemjiste.mk](http://www.gradezno-zemjiste.mk), në të cilën shënohet se për cilën parcelë ka të bëjë vet fletëparaqitja dhe cilat dokumente janë pjesë përbërëse e fletëparaqitjes), kompletuar me dëshmitë në vijim (të parashtruara në original ose kopje të vërtetuara në noter dhe të nënshkruara me nënshkrim digjital dhe autorizim të bartësit të nënshkrimit digjital të vërtetuar në noter).

1. Fletëparaqitje nga dërguesi, në të cilën janë të shënuara të dhënat për shtresin e fletëparaqitjes;

2. Garancia bankare për seriozitet të ofertës për secilën parcelë ndërtimore është përcaktuar në pajtim me Pasqyrën tabelore të dhënë në këtë shpallje me afat në kohëzgjatje deri më 31.01.2019, me të cilën ofertuesi do të garantojë se nëse e merr statusin e ofertuesit më të volitshëm do të paguajë deri në fund çmimin e arritur për tjetërsim të tokës ndërtimore të ankandit publik elektronik në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të lajmërimit me shkrim për zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm;

3. Për personat fizik certifikatë të shtetësisë;

4. Për personat juridik dëshmi për regjistrim të personit juridik nga regjistri përkatës;

5. Autorizim të rregulluar për të autorizuarin që do të përfaqësojë personin juridik, të vërtetuar në Noter, gjegjësisht dëshmi për cilësinë personi i autorizuar i subjektivit juridik;

6. e-mail adresë të dërguesit të fletëparaqitjes, përmes të cilit do të kryhet procedura e regjistrimit për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik, gjegjësisht do t'i dërgohen emri përdorues dhe fjalëkalimi për qasje në internet faqen në të cilën do të realizohet ankandit publik elektronik (për shtresin e fletëparaqitjeve të cilët do të dërgojnë e-mail adresë të gabuar, Komuna Bogdanci nuk e ka obligim ta pranojë të njëjtën dhe t'i bëjë korrigjim)

Komisioni pas kalimit të afatit për parashtrimin e fletëparaqitjeve, përcakton nëse fletëparaqitjet janë të kompletuara dhe të parashtruara në pajtim me kushtet e shpalljes. Komisioni informon parashtruesit e fletëparaqitjeve për kompletimin e të njëjtave përmes formës elektronike, në afat prej 24 orëve pas kalimit të afatit për parashtrimin e të njëjtave, pas çka parashtruesve të fletëparaqitjeve që kanë parashtruar dokumentacion të kompletuar u dërgon emër përdorues dhe shifër për pjesëmarrje në ankandin publik, ndërsa parashtruesve të fletëparaqitjeve që nuk kanë dorëzuar dokumentacion të kompletuar u dërgon lajmërim me arsyetimin se të njëjtit nuk do të marrin pjesë në ankandin publik.

Fletëparaqitjet të cilat nuk janë të kompletuara me këto dëshmi nuk do të marrin pjesë në ankandin publik elektronik për çka dërguesit e fletëparaqitjeve të pakompletuara do të informohen në mënyrë elektronike.

**ÇMIMI FILLESTAR**

Çmimi fillestar i ankandit publik elektronik për parcelat ndërtimore në Pasqyrën tabelore nr. 1 është 61,00 denarë për metër katror.

**GARANCIA BANKARE**

Garancia bankare për seriozitet të ofertës për secilën parcelë ndërtimore është përcaktuar në pajtim me Pasqyrën tabelore të dhënë në këtë shpallje.

**AFATET**

Fletëparaqitjet për pjesëmarrje në ankandin publik mund të dorëzohen deri më 15.10.2018 në formë elektronike në internet adresën në vijim: [www.gradezno-zemjiste.mk](http://www.gradezno-zemjiste.mk).

Ankandi publik do të mbahet në mënyrë elektronike në internet faqen në vijim [www.gradezno-zemjiste.mk](http://www.gradezno-zemjiste.mk)

Ankandi publik do të fillojë më datë 17.10.2018 në ora

- 08:30 për parcelën ndërtimore PN nr. 4

- 08:45 për parcelën ndërtimore PN nr. 5

- 09:00 për parcelën ndërtimore PN nr. 6

- 09:15 për parcelën ndërtimore PN nr. 7

- 09:30 për parcelën ndërtimore PN nr. 8

- 09:45 për parcelën ndërtimore PN nr. 10

- 10:00 për parcelën ndërtimore PN nr. 11

- 10:15 për parcelën ndërtimore PN nr. 12

- 10:30 për parcelën ndërtimore PN nr. 13

- 10:45 për parcelën ndërtimore PN nr. 14

dhe i njëjti do të zgjasë nga 15 minuta për secilën nga parcelat e theksuara

**PROCEDURA**

1. Komisioni i lajmëron parashtruesit e fletëparaqitjeve për kompletimin e po të njëjtave në mënyrë elektronike, në afat prej 24 orëve nga parashtrimi i të njëjtës, gjatë së cilës parashtruesit e fletëparaqitjeve që kanë dorëzuar dokumentacion të kompletuar, ju kanë dorëzuar emër i përdoruesit dhe shifër për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik, ndërsa parashtruesve të fletëparaqitjeve që nuk kanë dorëzuar dokumentacion të kompletuar ju dorëzojnë lajmërim me arsyetim se të njëjtit nuk do të marrin pjesë në ankandin publik.

2. Në ditën e mbajtjes së ankandit publik elektronik, pjesëmarrësit kanë qasje në faqen e internetit me emrin përdorues dhe shifër që e kanë marrë në e-mail adresën, bashkëngjitur me fletëparaqitjen për pjesëmarrje në ankandin publik.

3. Ankandi publik elektronik mund të fillojë me së paku një pjesëmarrës në ankandin publik për secilën parcelë ndërtimore veç e veç.

4. Ankandin elektronik publik, e ndjek Komisioni, i formuar nga Kryetari i Komunës Bogdanci me Vendimin nr. 09-1649/1 të datës 10.09.2018.

5. Ankandi elektronik publik fillon me shpalljen e çmimit fillestar të tokës në metër katror, ndërsa zbatohet nëpërmjet mënyrës së ankandit nga ana e pjesëmarrësve.

6. Ankandi realizohet "hap pas hapi", dhe lartësia e vlerës së çdo "hapi" jo më pak se 10.00 denarë për parcelat ndërtimore të theksuara në Pasqyrën tabelore nr. 1

7. Ankandi elektronik publik konsiderohet si i mbaruar në momentin e kalimit të afatit të përcaktuar pas kësaj shpallje, gjatë së cilës nëse në dy minutat nga ana e pjesëmarrësve është dhënë ofertë, afati i fundit për mbarim të ankandit publik, vazhdohet për dy minuta, ndërsa do të përfundojë kur në periudhë prej dy minutave të ardhshme nuk do të jepet ofertë e re. Ankandi publik vazhdon pa kufi derisa në intervalin kohor prej dy minutave ka ofertë të re.

8. Pjesëmarrësi i ankandit publik që ka ofruar çmim më të lartë, fiton statusin ofertuesi më i volitshëm.

9. Komisioni pas përfundimit të ankandit publik përgatit procesverbal për zbatimin e ankandit publik dhe në mënyrë elektronike i dorëzon deri të gjithë pjesëmarrësve në ankandin publik.

10. Pas përfundimit të procedurës së ankandit publik Komisioni është i obliguar që në afat prej tri ditë pune të dorëzojë kërkesë për mendim deri te Avokati shtetëror i Republikës së Maqedonisë për propozim-tekst të kontratës për tjetërsim të tokës ndërtimore pronë e R. Maqedonisë.

11. Avokati shtetëror i R. Maqedonisë obligohet që të dorëzojë mendim për propozim-tekstin për marrëveshjen për tjetërsim të tokës ndërtimore pronë e R. Maqedonisë në afat prej 30 ditë nga marrja e kërkesës për mendim. Nëse në afat prej 30 ditëve Avokati shtetëror i R. Maqedonisë nuk parashtron mendim, do të konsiderohet si pozitiv.

12. Pas marrjes së mendimit pozitiv nga Avokati shtetëror i Republikës së Maqedonisë, komisioni në afat prej tri ditë pune deri te ofertuesi më i volitshëm dorëzon lajmërim për zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm.

13. Ofertuesi më i volitshëm ka për obligim të paguajë mjetet në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të lajmërimit me shkrim për zgjedhje dhe deri tek Komisioni të dorëzojë dëshmi për pagesën e realizuar.

14. Nëse ofertuesi më i volitshëm nuk i paguan mjetet brenda afatit të caktuar, garancia bankare për seriozitet të ofertës do të aktivizohet dhe nuk do të lidhet marrëveshje dhe i njëjti nuk do të mund të marrë pjesë në çdo ankand tjetër publik për parcelën ndërtimore në fjalë.

15. Nëse ofertuesi më i volitshëm paguan mjetet në pajtim me çmimin e arritur përfundimtar nga ankandi publik brenda afatit të caktuar, ndërsa në bazë të dokumentacionit të parashtruar nuk mund të lidhet marrëveshje, mjetet e paguara për tjetërsim të tokës ndërtimore nuk do t'i kthehen, garancia bankare për seriozitet të ofertës aktivizohet dhe nuk do të lidhet marrëveshje.

16. Në afat prej pesë ditëve të punës pas dorëzimit të dëshmisë për pagesën e realizuar dhe dorëzimit të dokumentacionit të tërësisht të nevojshëm për pjesëmarrje në ankandin publik, Kryetari i Komunës Bogdanci në emër të R.

Maqedonisë do të lidhë marrëveshje për tjetërsim të tokës ndërtimore pronë e R. Maqedonisë.

17. Pas lidhjes së marrëveshjes Komuna Bogdanci në afat prej një dite, në mënyrë elektronike dorëzon marrëveshjen në departamentin për çështje financiare për përcaktimin e tatimit të qarkullimit të patundshmërive. Blerësi është i obliguar në afat prej 15 ditëve nga marrja e vendimit për përcaktimin e tatimit të qarkullimit të patundshmërive të paguajë tatimin dhe të dorëzojë dëshminë për pagesën e realizuar.

18. Pas parashtrimit të dëshmisë për pagesën e realizuar të tatimit të qarkullimit të patundshmërive, blerësi në afat prej 15 ditëve, marrëveshjen në mënyrë elektronike e parashtron deri te noter i kryerje të solemnizimit. Blerësi është i obliguar që solemnizimin ta kryejë në afat prej 30 ditëve nga dita e dorëzimit të marrëveshjes tek noter i autorizuar.

19. Mospërbushja e obligimeve nga pikat 17 dhe 18 të kësaj shpallje me faj të blerësit paraqet bazë të njëanshme për anulim të marrëveshjes gjatë së cilës 80% e shumës së përgjithshme nga tjetërsimi nuk i kthehet blerësit.

20. Me marrëveshjen blerësi obligohet që të sigurojë leje për ndërtim të objektit të paraparë nga organi kompetent në afat prej 9 muajve nga solemnizimi i realizuar i marrëveshjes ku lëndë e marrëveshjes është parcelë ndërtimore me sipërfaqe deri më 5.000 m<sup>2</sup>, gjegjësisht në afat prej 12 muaj nga solemnizimi i realizuar i marrëveshjes ku lëndë e marrëveshjes është parcelë ndërtimore mbi 5.000 m<sup>2</sup> dhe obligohet në tokë të ndërtojë në pajtim me planin urbanistik sipas të cilit i njëjti është i tjetërsuar. Blerësi obligohet që objektin ta ndërtojë në pajtim me planin urbanistik sipas të cilit toka është e tjetërsuar, në afat jo më të gjatë se 2 (dy) vjet nga marrja e lejes së plotfuqishme për ndërtim për objektet me bruto sipërfaqe të ndërtuar deri në 1000 m<sup>2</sup>, në pajtim me lejen e marrë për ndërtim, gjegjësisht në afat prej 4 (katër) vjet nga marrja e lejes së plotfuqishme për ndërtim për objektet me bruto sipërfaqe të ndërtuar mbi 1000 m<sup>2</sup>, në pajtim me lejen e marrë për ndërtim, në të kundërtën nëse blerësi nuk nxjerr leje për ndërtim brenda afatit të paraparë, gjegjësisht nëse objektet nuk ndërtohen brenda afatit të caktuar me faj të blerësit, i njëjti obligohet që të paguajë penale të marrëveshjes në shumë prej 1,5% të çmimit të përgjithshëm të arritur në ankandin publik të tokës në fjalë për secilin muaj të kaluar në vitin e dytë të kohës së afatit të kaluar, gjegjësisht 4,5 % të çmimit të përgjithshëm të arritur në ankandin publik të tokës në fjalë për secilin muaj të kaluar në vitin e tretë dhe çdo viti të ardhshëm të kohës së afatit të kaluar. Ofertuesi më i volitshëm obligohet të paguajë tatimin e qarkullimit që do të dalë si obligim pas marrëveshjes së lidhur për tjetërsim të tokës ndërtimore.

21. Shuma e shpenzimeve të posaçme në procedurën e tjetërsimit të tokës ndërtimore është 10% e vlerës së garancisë bankare për seriozitet të ofertës.

22. Përqindja minimale që duhet të ndërtohet nga sipërfaqja e përgjithshme e zhvilluar për ndërtim e paraparë me planin urbanistik për parcelat ndërtimore në fjalë nuk guxon të jetë më e vogël se 30%.

23. Pronari i tokës ndërtimore të fituar në procedurën për tjetërsim nëpërmjet ankandit publik nuk guxon të njëjtën ta bartë tek personat e tretë, para plotësimit të obligimeve nga kontrata për tjetërsim të njëjtës. Ndërsa për bartjen në persona të tretë shënohet në librin publik për regjistrim të të drejtave të patundshmërisë.

24. Në çmimin e tokës ndërtimore nuk është përfshirë kompensimi për rregullimin e tokës ndërtimore.

25. Shpenzimet për procedurën materiale dhe futjen në evidencë të patundshmërive në Agjencinë për kadastrë të patundshmërive bien në barrë të blerësit të tokës ndërtimore.

26. Pjesëmarrësit e pakënaqur në ankandin publik mund të shprehin apel deri tek Komisioni në afat prej 3 (tre) ditëve nga mbajtja e ankandit publik elektronik. Pas apelit Komisioni obligohet që të vendosë në afat prej 5 (pesë) ditëve nga pranimi i të njëjtit.

27. Kundër vendimit të sjellë nga ana e komisionit, që vendoset pas apelit të parashtruar, pala ka të drejtë të parashtrorë ankësë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të vendimit deri te Komisioni shtetëror për vendosje në procedurë administrative dhe procedurë të marrëdhënies së punës në shkallë të dytë.

28. Garancia bankare për seriozitet të ofertës për secilën parcelë ndërtimore do të vlejë deri më 31.01.2019 për ofertuesin më të volitshëm, ndërsa për të gjithë të tjerët pas përfundimit të ankandit publik.

Kjo shpallje do të publikohet në UEB faqen e Komunës Bogdanci, [www.bogdanci.gov.mk](http://www.bogdanci.gov.mk)

Komisioni për realizimin e procedurave për ankand publik



# KAPEN 50 EMIGRANTË NË NJË "IVEKO"

Në autostradën Gjevgjeli—Shkup në afërsi të fshatit Smokvicë, dje në orën 11, nëpunësit policorë në një automjet transportues "Iveko" me tabella regjistrimi të Shkupit i kanë gjetur 50 emigrantë nga Pakistani dhe Afganistani, prej të cilëve katër janë femijë.

Nga MPB në kumtesë sot sqarojnë se nëpunësit policorë kanë dhënë shenjë për ndalimin e automjetit motorik "Iveko" me ç'rast drejtuesi e ka ndaluar automjetin 50 metra pas patrullës dhe është arratisur nga vendi i ngjarjes.

"Gjatë kontrollit të automjetit, në hapësirën për ngarkesë, janë gjetur 50 emigrantë nga Pakistani dhe Afga-



nistani, prej të cilëve katër janë femijë. Emigrantët janë dërguar në Qendrën transitorë të pranimit Gjevgjeli për procedurë të mëtejme.

Janë duke u ndërmarrë masa për gjetjen e drejtuesit dhe për zbardhjen e plotë të rastit", thuhet në kumtesën e MPB-së.

## Ngritet akuza për rastin "Sazdovski"

Shkup, 11 shtator- Prokuroria e Shkupit deri te Gjykata Penale e Shkupit ka dorëzuar akuzën kundër personave të dyshuar për vrasjen e riut Nikolla Sazdovski, në qershor të këtij viti. Të akuzuarit ngarkohet veprën penale "Vrasje", dhe se të njëjtit bashkërisht në mënyrë mizore e kanë goditur për vdekje të dëmtuarin, tashmë të ndërë Sazdovski.

"Të akuzuarit me 29 qershor të këtij viti, rreth orës 17:30, në bulevardin 'Aleksandar Makedonski' në Shkup, në stacionin e autobusëve afër fabrikës Allkallodi, i janë afruar të dëmtuarit dhe i kanë kërkuar letër njoftim. Pas i njëjti u ka dhënë letër njoftimin, të akuzuarit papritmas kanë filluar ta godasin me grusht në pjesën e kokës dhe gjoksit. Nga goditjen e rënda i dëmtuar e ka humbur baraspeshën dhe ka rënë në trotuar. Njëherit të akuzuarit pa mëshirë dhe me goditje të rënda kanë vazhduar ta shqelmojnë në pjesën e kokës dhe gjoksit. Si rezultat i këtij sulmi i dëmtuari ka pësuar lëndime të rënda trupore, me rrezik konkret për jetën e tij dhe kështu ai ka rënë në gjendje kome. Në të njëjtën ditë ai ka qenë i dërguar në Qendrën Klinike në Shkup, Sektori për anestezi dhe reanimacion, me çka me tre korrik është konstatuar vdekje e trurit, gjegjësisht me 9 korrik i dëmtuari ka nderuar jetë", thonë nga Prokuroria e Shkupit. Paralelisht me dorëzimin e propozim akuzës, prokurori përkatës ka dorëzuar propozim për vazhdimin e masës së paraburgim për dy nga tre të akuzuarit. Ngritjen e aktakuzës kundër të akuzuarve për vrasjen e riut Nikolla Sazdovski, Prokuroria e Shkupit e arsyeton me faktin se gjatë periudhës së kaluar është realizuar procedurë hetimore, ku të akuzuarit dhe palët tjera kanë dhënë dëshmitë e tyre. Mbase i akuzuari i tretë i cili akuzohet për bashkëvepruar nuk është i kapshëm për organet e rendit, prokuroria e ka ndërprerë procedurën hetimore dhe e njëjta do të vazhdojë pasi i njëjti të arrestohet.


## Një 18 vjeçar shqiptar ka vdekur në Zvicër

Një i ri shqiptar është gjetur i vdekur pranë një makine në Zvicër. Sipas mediave vendase trupi i të riut identiteti i të cilit ende nuk dihet, është gjetur pranë magjistrales A1 në Bassendorf Zh, të Zvicrës.


Nga raportimet e para mësohet se i riu është vetëm 18 vjeç. Ai ndodhej pranë një veturë të dëmtuar, duke hedhur dyshimet e para për një vdekje ne aksident, por pritet ende ekspertiza dhe hetimet policore.

"Arsyet e vdekjes janë akoma të paqarta," thonë nga policia. Policia lokale beri me dije se trupi i pajete ndodhej në anën e djathtë të automjetit në vendin e pasagjerit, nderkohe që dera ishte e hapur.

Publicitet



Republika e Maqedonisë  
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor



**Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor e Republikës së Maqedonisë:**

**SHPALL**

**Kërkesën për dhënie e Lejes për shfrytëzim të ujit nga pusi për nevoja industriale, teknologjike dhe ekonomike, në fakt për nevojat e minierës të planifikuar për eksploitim të legurave të bakrit, në sasi prej Q=2.15 l/s.**

Në pajtim me nenin 30 paragrafi (1) të Ligjit të Ujërave ("Gazeta zyrtare e R. Maqedonisë nr. 87/08, 06/09, 161/09, 83/10, 51/11, 44/12, 23/13, 163/13, 180/14, 146/15 dhe 52/16), Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor iu dorëzuar kërkesa për dhënie e Lejes për shfrytëzim të ujit nga pusi (ujërat nëntokësore) për nevojat e minierës të planifikuar për eksploitim të legurave të bakrit, në sasi prej Q=2.15 l/s.

**Parashtruesi i kërkesës:**  
NPSHSH Borov Dol SHPKNJP – Radovish  
rr. Sveti Spaso Radovishki  
2420 Radovish

Pusi 1 është në pjesën PK 2345, dorësa pusi 2 dhe 3 janë në pjesën PK 1918, KK Brest Komuna e Shtipit

Koordinatat e puseve të projektuara për shfrytëzim janë këto:

PPSH-1	Y: 7.611.736,27	X: 4.607.688,68
PPSH-2	Y: 7.611.576,96	X: 4.607.628,68
PPSH-3	Y: 7.611.575,63	X: 4.607.615,37

Informacione në lidhje me kërkesën, publiku i interesuar mund të marrë në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, në e-mail [b.nikceovski@moepp.gov.mk](mailto:b.nikceovski@moepp.gov.mk)

Publiku i tanguar, në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit të kërkesës, ka të drejtë të dorëzojë komentet dhe vërejtjet në formë të shkruar te Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor bulevardi "Goce Dellçev" nr. 18 ndërtesa e RTVM (kati i 10), 1000 Shkup.

Në bazë të nenit 169 dhe 172 e Ligjit për arsim sipëror (Gazeta Zyrtare e RM nr. 82/2018), nenit 46 të Rregullores për marrëdhëniet e brendshme dhe punës së Fakultetit për arsim fizik, sport dhe shëndet në përbërje të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup dhe vendimit të Këshillit mësimor-shkencor, dekani i Fakultetit të edukatës fizike, sportit dhe shëndetit në Shkup, publikon

**KONKURS**

Për zgjedhje të mësimdhënësit në të gjitha titujt mësimor-shkencor

- Zgjedhje të 1 (një) mësimdhënësit në të gjitha titujt mësimor në sferën mësimore-shkencore: kiezilogjia aplikative, për realizim të lëndës: sport dhe shëndet, (zgjedhja është për kohë prej pesë vite)

Kushtet: Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme, duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim sipëror dhe aktet tjera të Universitetit.

Vendi i punës – mësimdhënës me titull mësimor, orari i punës është 40 orë në javë, me dy ndërrime: dy javë paradite prej ora 7:30 deri në ora 15:30, dy javë pasdite prej ora 13:30 deri në ora 21:30, në pajtim me orarin e orëve në semestër. Bruto pagesa fillestare është 43.184,00 denarë.

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të parashtrorin: fletëparaqitje sipas konkursit, biografi të shkurtë, dëshmi për plotësim të kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës (dokument për arsim të mbaruar, listë të punimeve të publikuara profesionale – nga një kopje të punimeve), certifikatë të shtetësisë.

Zgjedhja e kandidatëve bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për arsim sipëror (Gazeta Zyrtare e RM nr. 82/2018).

Dokumentet të parashtrorin në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter.

Konkursi zgjatë 8 ditë nga dita e publikimit.

Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e nevojshëm të dorëzohen në adresën: Fakulteti për arsim fizik, sport dhe shëndet në Shkup, rr. Dimçe Mirçev nr. 3, 1000 Shkup, Fahu P. 681.

Informata plotësuese në telefonin: 02 3113 654 Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, Fakulteti për arsim fizik, sport dhe shëndet – Shkup

Fakulteti për arsim fizik, sport dhe shëndet – Shkup



Alb Kultura

**Shpallet konkurs për pjesëmarrje në festivalin e muzikës zbavitëse shqipe "Boom Fest" 2018, edicioni i parë.**

Pjesëmarrësit e interesuar duhet të kenë këngën në WAV format, master ose demo incizim.

Për informata më të hollësishme, na shkruani në e-mail adresën.

[boomfestivali@hotmail.com](mailto:boomfestivali@hotmail.com)

ose në

tel. +38970622059.

**Konkursi është i hapur deri me 01.10.2018.**

# Veting apo poligraf për politikanët?



Nga  
Eduard Zaloshnja

Vettingu (thënë shqip, sita) për gjyqtarët dhe prokurorët, synon të nxjerrë jashtë sistemit të drejtësisë ata persona që, ose janë të lidhur me krimin, ose nuk justifikojnë pasurinë familjare, ose nuk janë të aftë profesionalisht. Për dy të parat, verifikohen të dhënat nga burime të ndryshme, ndërsa për të fundit, analizohen dosjet dhe vendimet e secilit gjyqtar ose prokuror që kalon në sitë.


Partia Demokratike ka depozituar në Kuvendin e Shqipërisë një projektamendim kushtetues që, me pak fjalë, propozon vettingun për politikanët, të ngjashëm me atë për gjyqtarët/prokurorët. I vetmi ndryshim është se, PD-ja nuk kërkon verifikimin e aftësive profesionale të politikanëve. Dhe me të drejtë, sepse për to, janë votuesit që japin verdiktin.

Sidoqoftë, për verifikimin e lidhjeve me krimin ose të pasurive familjare të politikanëve, duhet shumë kohë e shumë shpenzime, siç po ilustron edhe nga procesi i vettingut të gjyqtarëve/prokurorëve. Për më tepër, është shumë e vështirë të ngrihet një komision hetimi ose apelimi për politikanët, i pavarur nga politika. Kush politikan mund të votojë pro një anëtar komisioni, për të cilin ka dyshimin se mund të japë viston për largimin e tij nga politika?!

Meqenëse kriteri profesional nuk bën pjesë në paketën e propozuar nga PD-ja për vettingun e politikanëve, ajo mund të propozojë një mekanizëm shumë më të thjeshtë e shumë me më pak kosto, për të kaluar në sitë politikanët. Quket poligraf.

Pas botimit të një editoriali anonim në gazetën "Nju Jork Tajms", në të cilin një zyrtar i lartë i administratës Trump, e cilësonte presidentin si amoral dhe si një lider që merr vendime të nxituara e të paprincipia, zv. Presidenti Pence deklaroi publikisht se nuk ishte autori anonim i editorialit, dhe se ishte gati t'i nënshtrohej një testi në makinën poligraf – makina e së vërtetës. Këtë deklaratë e bëri, pasi u aludua në menia se ishte pikërisht ai autori anonim, ngaqë në të ishte përdorur një fjalë e rrallë, që e ka përdorur shpesh në shkrimet/fjalimet e tij.

Në qoftë se Pence e kalon testin e poligrafit, probabiliteti është



99% që ai nuk është autori i editorialit të sipërcituar. Vetëm agjentë specialë, super të trajnuar, janë në gjendje ta kalojnë testin poligraf, kur gënjejnë. Kështu, Aldrich Ames që kishte punuar 30 vjet për CIA-n, ishte rekrutuar në fund të karrierës nga KGB-ja, së cilës i kishte dhënë materiale shumë të ndjeshme (në përputhje me postin e


lartë në CIA). Testet rutinë të poligrafit (që u bëhen çdo vit punonjësve të CIA-s), nuk arritën t'i zbulonin gënjeshtret e tij, sepse ai kishte trajnuar vartësit si t'i shpëtonin një testi të tillë, nëse kapehin nga rusët. (E ngjashme është edhe historia e veteranit të FBI-së, Robert Hanssen, disa vite pas Amesit).

Me pak fjalë, testi poligraf ka një përqindje shumë të ulët të rezultateve falsë negative. Pra, në fare, fare pak raste, mund të qëllonjë që testi të nxjerrë dikë si tregues të së vërtetës, kur ai gënjen. Dhe çështje më e bukura, makina që shërben për kryerjen e testit është me kosto shumë të ulët – rreth 10 mijë euro.

Në rastin e politikanëve tanë, ata që nuk e kalojnë dot testin e poligrafit vetëm për pak pikë, mund t'i nënshtrohen një procedure apelimi. Së pari, mund të rristohen në makinën poligraf dhe së dyti, mund të analizohen nga një komision apelimi, i përbërë nga anëtarë të komisioneve aktualë të vettingut, të përzgjedhur me short.



## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovajsa lok.14 - përdheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribucioni: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e martë 11 shtator | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006  
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA  
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3179 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221  
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Testi i poligrafit bazohet në matjen e disa treguesve fizikë, si rrahjet e zemrës, djersitja, temperatura e trupit, tensioni, etj., gjatë kohës që i testuari i përgjigjet pyetjeve me një "po" ose me një "jo" të prerë. Në baterinë e pyetjeve që i bëhen të testuarit, disave u dihet paraprakisht përgjigjja në mënyrë absolute. (Për shembull, "A e ke emrin Edi?"). Kur bëhen pyetje që s'u dihet paraprakisht përgjigjja, në qoftë se ka luhajtje të treguesve të mësipërm, lind dyshimi se i testuari po gënjen. Dhe më tej, thellohet intervista.

Me 10 makina të tilla (dhe me 10 profesionistë që dinë t'i përdorin ato), vettingu i propozuar nga PD-ja për politikanët mund të mbarojë ndoshta për 10 ditë. Sepse ata nuk do të kalojnë në sitë për aftësitë e tyre profesionale (ndryshe nga gjyqtarët/prokurorët), gjë të cilën nuk e teston dot poligrafi. Testi i poligrafit vetëm mund të tregojë, nëse politikanin i testuar ka lidhje me krimin ose nëse ai/familjarët kanë marrë të ardhura/pasuri të paligjshme.

Por a ka rrezik që i njomi të digjet me të thatin nga poligrafi?

Përqindja e rezultateve falsë pozitive është relativisht e lartë për poligrafën (rreth 5%). Pra, në 5% të rasteve, dikush mund të thotë të vërtetën, por për faj të emocioneve, mund të regjistrojë luhajtje të treguesve që mat makina e poligrafit. Pikërisht për këtë arsye, gjykatat në vendet perëndimore nuk e pranojnë testin e poligrafit si provë përfundimtare fajësie (dikush duhet të dënohet, vetëm kur provohet se është fajtor përtej çdo dyshimi të arsyeshem).

Në rastin e politikanëve tanë, ata që nuk e kalojnë dot testin e poligrafit vetëm për pak pikë, mund t'i nënshtrohen një procedure apelimi. Së pari, mund të ristestohen në makinën poligraf dhe së dyti, mund të analizohen nga një komision apelimi, i përbërë nga anëtarë të komisioneve aktualë të vetingut, të përzgjedhur me short.

Në qoftë se PD-ja e ka seriozisht vettingun e politikanëve shqiptarë, le të propozojë atë që zv. presidenti amerikan propozoi për veten e tij – testin poligraf. Përndryshe, vettingu i stërzgatur i politikanëve, me metodën aktuale, nuk jep shpresë se do të realizohet ndonjëherë. Ai mund të duket thjesht si një kartë elektorale e PD-së, të cilën makina propagandistike e qeverisë mund ta copëtojë dalëngadalë... (AFP)

# Dialogu Thaçi-Vuçiç dhe teza e çmëndur e shtetit etnik



Nga  
Skënder Minxhozi

Shumëkush e kujton pa ndonjë farë mundimi, këshillën historike që u është dhënë shqiptarëve nga miq e armiq, gjatë gjithë shekullit të shkuar, kur punët në Ballkan e Europë ndodheshin në zgrip: mos evokoni Shqipërinë etnike, mos e përmendni, madje as në ëndërr mos e shihni, sepse është një ide e keqe, një shpresë e kotë, një dëshirë që shkatërron paqen, stabilitetin dhe të ardhmen tuaj e të tjerëve rreth jush! Na e kanë thënë këtë aq shpesh, saqë breza të tërë shqiptarësh janë rritur me gogolin e Shqipërisë së Madhe në subkoshiençën e tyre.

Qëllimi i kësaj propogande të fortë që ushtrohej mbi Shqipërinë e Madhe, e cila të përfshinte të gjitha viset ku jetonin shqiptarë, bazohej mbi një parim themelor të marrëdhënieve mes shteteve, pas dy luftrave botërore, kur edhe morën trajtë të qëndrueshme kufinj të Europë: mosndryshimi i kufinjve sipas kritereve etnike. Arsyeja është më e thjeshta e imagjinueshmja. Nëse ndodh që evropianët t'i kthehen projektit të shtetit etnik, kontinenti praktikisht duhet të nisë një luftë të tretë botërore. Të gjitha vendet evropiane kanë probleme me fqinjët, të gjithë kanë pakica matanë kufinjve të tyre. Aq më tepër Ballkani, fuçia e vjetër e barutit, ku etnitë janë pleksur mes tyre në një lëkurë leopardi që s'ka Zot ta deshifrojë.

E pra mesa duket erdhi koha që liderët e Ballkanit, ta hedhin hapur idenë e shtetit me bazë etnike. E ka bërë këtë, siç raportojnë mediat, presidenti i Serbisë Aleksandër Vuçiç, e pas tij edhe ministri i jashtëm serb Daçiç, që ka dalë hapur në favor të idesë së shkëmbi-

mit të territoreve me Kosovën, me qëllim që secila palë të grupojë në kufinj të saj etninë e vet.

"Unë jam në favor dhe kjo është politika ime për ndarjen me shqiptarët, sepse të kemi një territor që nuk dihet se kush e trajton atë dhe se kujt i përket, është gjithmonë një burim konfliktesh të mundshme. Nuk e fsheh një synim të tillë, por nuk dihet nëse këtë do ta pranojë populli serb apo jo, dhe nëse do të ketë sukses, kjo nuk varet vetëm nga Serbia", ka thënë presidenti Serb. Duke artikuluar një tezë e cila, siç po thuhet me dhjetra herë këto orë, prodhon riskun më të madh të imagjinueshëm të një efekti domino, i cili do të shkaktonte një luftë me përmasa, aktorë dhe pasoja tërësisht të paparashikueshme. Me precedentin Thaçi-Vuçiç në xhep, çdo vend i botës mund të reklamonte të drejtën për të grupuar rreth vetes territore etni të ndodhura jashtë kufirit të vet shtetëror. A nuk u përdor edhe Kosova si precedent nga Rusia, kur aneksoi Krimenë?!

Nxitimi i ministrit të jashtëm serb Daçiç, për të përkrahur deklaratat e Vuçiç, në prani të zëdhënës së ministrisë së jashtëm ruse e cila po viziton Beogradin, tregon sesa e gatshme është Serbia që ta fusë edhe një herë në lotarinë e bisedimeve çështjen e integritetit territorial të Kosovës. Daçiç ka deklaruar madje se tani që po rikthehet në tryezë çështja e ndryshimit të kufinjve, më në fund qëndrimi historik i Serbisë kundër ndërhyrjes perëndimore në Kosovë, ka dalë i fituar. Një shpagim i vonuar "moral" për këtë delfin të dikurshëm të Millosheviçit, por situata që po projektohet shkon shumë përtej këtyre detajeve.

T'i lësh kufinj të rajonit në dorë të elitës aktuale politike, është një lloj si të lësh bombën atomike në dorën e Kim Jon Un-it. Dy liderë me një nivel aq të thellë mosbesimi mes tyre dhe që përfaqësojnë dy popuj me një armiqësi të thellë dhe interesa historikisht kryekëput të kundërta, janë dyshja më e papërshtatshme për t'u marrë me një materie kaq delikate e eksplozive, siç janë kufinj të.

Me afirmimin e hapur të dëshirës për të korigjuar kufinj të shtetërorë sipas linjave etnike, lideri serb po shkel në një tokë të minuar. Dëshira e Hashim Thaçit për t'i shkruar pas, qoftë edhe nga pozitë e tij, kësaj ideje të çmëndur, e bën të rrezikshme klimën që po përvijohet. Nëse procesi i dialogut Kosovë-Serbi kryhet i pamonitoruar nga palë të treta dhe pa një listë "vijash të kuqe", siç ka qenë tradicionalisht rasti kur kanë folur serbë dhe shqiptarë, produkti mund të jetë eksploziv për sot dhe për nesër. Për fat të keq, Europa dhe SHBA duken të ndara momentalisht në këtë pikë. Mesa duket për shkak të diplomacisë akrobatike të Donald Trump, i cili pasi zhvendosi ambasadën amerikane nga Tel Avivi në Jerusalem dhe pasi po bën piruetat të pashpjegueshme sa me Iranin, apo me Korenë e Veriut, tani ndoshta mund të jetë duke i hapur rrugë një eksperimenti të rrezikshëm në Ballkan.

T'i lësh kufinj të rajonit në dorë të elitës aktuale politike, është një lloj si të lësh bombën atomike në dorën e Kim Jon Un-it. Dy liderë me një nivel aq të thellë mosbesimi mes tyre dhe që përfaqësojnë dy popuj me një armiqësi të thellë dhe interesa historikisht kryekëput të kundërta, janë dyshja më e papërshtatshme për t'u marrë me një materie kaq delikate e eksplozive, siç janë kufinj të.

Aleksandër Vuçiç dhe Hashim Thaçi s'mund të marrin në dorë lapsin e vizatimit të hartës së Ballkanit. Sidomos nëse do të duan ta vizatojnë atë sipas kritereve etnike, siç po deklarohen së fundi. Sepse pasojat e një lodre të tillë të rrezikshme, shkojnë parimisht përtej çdo imagjinate të një njeriu normal.



Para se të nisesha për Palestinë, veterani i gazetarisë, Nehat Islami, më porositi që të isha i durueshëm gjatë kontrollit të autoriteteve izraelite, si në aeroportin e Tel-Avivit, ashtu edhe në pikat e kontrollit në rrugë për në Ramallah (check point) dhe të mos bija pre e provokimeve të mundshme. Ndër gjërat e para që marr nga mikpritësi është një pllakat, në të cilin është shtypur, kuptohet në arabisht, poezia ime "Leksion i vogël për Atdheun", në vargjet e së cilës përmendet Palestina



Shkruan: Agim Vinca

Një telefonatë e zonjës Maïthé Vallès-Bled, drejtoreshë e festivalit të poezisë "VOIX VIVES, de Méditerranée en Méditerranée" (ZËRA TË GJALLË, nga Mesdheu në Mesdhe) rreth dy muaj më parë për të marrë pjesë në edicionin e dytë të këtij festivali në Ramallahmë vuri në dilemë: të merrja rrugën për në Palestinë apo jo? (Të themi se festivali me traditë 21-vjeçare ZËRA TË GJALLË, nga Mesdheu në Mesdhe, i cili mbahet për çdo vit në javën e fundit të korrikut në qytetin bregdetar Sète/Setë të Francës, nga viti 2013 e ka zgjeruar veprimtarinë vet edhe në disa vende të tjera të Mesdheut, përfshirë edhe Palestinën). Rruga për në Palestinë është e gjatë dhe e vështirë për shkak të marrëdhënieve izraelito-palestineze, por edhe shansi për të vizituar këtë vend nuk të jepet shpesh.

Pas konsultimit me mjekun që kujdeset për shëndetin tim, vendosa të shkoja në Ramallah, ku qëndrova nga data 13 deri më 19 gusht të këtij viti.

Një natë para se të nisesha për në Palestinë, piva një kafe me veteranin e gazetarisë kosovare, Nehat Islamin, i cili në vitet '70 ishte korrespondenti i "Rilindjes" nga Lindja e Afërt dhe e Mesme. Nehati më dha disa informacione të vlefshme për këtë pjesë të botës dhe veçanërisht për vendin ku shkoja, Palestinën, por nënvizoi se ato, si tha vetë, janë pak të vjetruara. Më porositi gjithashtu që të isha i durueshëm gjatë kontrollit të autoriteteve izraelite, si në aeroportin e Tel-Avivit, ashtu edhe në pikat e kontrollit në rrugë për në Ramallah (check point) dhe të mos bija pre e provokimeve të mundshme.

Udhëtova me aeroplan në relacionin: Prishtinë-Stamboll-Tel-Aviv. Nga Prishtina u nisa në mëngjes, rreth orës 9, kurse në orët e pasdites

## NË PALESTINË, PËR POEZINË



# FTESA NGA FRANCA DHE NISJA PËR NË "TOKËN E SHENJTË"



isha në Tel-Aviv, në aeroportin "Ben Gurion", ku më priste taksisti që do të më çonte në Ramallah.

Rruga nga Tel-Avivi në Ramallah zgjat rreth një orë e gjysmë, pa llogaritur kontrollin në pikën që ndan dy vendet, e cila, siç do të bindem më vonë, kur të kaloj nëpër të, t'i kujton skenat e filmave me temë totalitare dhe veçanërisht ato të romanit "1984" të Oruellit.

Nuk di se ç'bëri taksisti palestinez, ngai ra, por në të shkuar unë e shmanga këtë kontroll, që do ta përjetoja dy herët e tjera kur udhëtova nga Ramallahu në Jerusalem: herën e parë për të vizituar qytetin e lashtë (i tërë grupi i pjesëmarrësve në festival) dhe herën e dytë kur shkova në leximin letrar që ishte papaparë më 17 gusht (ditë e premte) në pjesën e vjetër të qytetit.

### TAKIMI IM I PARË ME PALESTINËN

Në Ramallah mbërrita në orët e vona të pasdites dhe u vendosa menjëherë në hotelin (si e quante organizatori) e Shkollës Teknike Episkopale, që në të vërtetë ishte një lloj konvikti me dhoma fjetjeje, restorant, bibliotekë, zyra, salla mësimi e leximi etj.

Pasi vendosem në dhomën modeste me tre shtretër, një dollap dhe një tavolinë, zbres poshtë për të pirë një kafe. Aty takoj, në hyrje të ndërtesës, një grup nxënësish a stu-

dentësh që po pushonin mes orëve të mësimit me profesorin e tyre në mes. Një nxënëse a studente (nuk e mora vesh mirë se ç'ishin, por kuptova se po mbanin kurse verore), më pyeti se nga vija. "Nga Shqipëria", i thashë, me shpresë se e njohin më shumë se Kosovën, por edhe nga që organizatori i festivalit më kishte prezantuar kështu në program: Agim Vinca (Albania). "Ku gjendet ky vend, në Europë?", pasoi pyetja e çuditshme për mua. "Po, në Europë", i them. "Në Ballkan". Vajza e re, e pa sherr, nis ta kërkojë në celular, ndërsa profesori i saj, me një nënqeshje ironike, tha: "Shqipëria, mbretëria e mafies!".

Ky ishte takimi im i parë me Palestinën, në të vërtetë me një palestinez, intelektual, pas atij me taksistin, me të cilin rrugës kisha shkëmbyer vetëm tek-tuk ndonjë fjalë. "Royaume de mafia", u shpreh profesori "i madh", siç e cilësoi veten njeriu që kisha përballë, të cilin nxënësit e tij e puthnin nga tri herë në faqe para se të largoheshin. E kundërshtova menjëherë, natyrisht. "Jo, i them, s'është e vërtetë! Është propagandë!", por në vete mendoj: "Ja si ia kemi nxjerrë namini e keq vetes! Shihni çfarë imazhi i kanë krijuar vendit, Shqipërisë, sikundër edhe Kosovës, qeveritarët e saj të papërgjegjshëm me veprimet e tyre, por edhe opozita e etshme për pushtet, që flet zi e më zi

për vendin e vet kudo që shkon. S'lë gjë pa thënë! Edhe media, sigurisht, media jonë e çoroditur dhe ajo e huaj që bazohet shumë here në të, ka "meritën" e vet në këtë mes.

Takimi i tretë me njerëzit e vendit në të cilin sapo kam shkelur, por për të cilin kam lexuar e dëgjuar aq shumë, është me drejtorin e muzeut "Mahmud Dervish", që është organizatori kryesor i festivalit, tok me drejtorinë e festivalit "mëmë" të Setës dhe bashkinë e Ramallahut, qytetit ku mbahet festivali. Drejtori Khader vjen me makinën e muzeut, e cila në xhamin e mbrapmë ka portretin e poetit, kurse në dyer mbishkrimin e institucionit, tok me një shokun e tij poet palestinez, që ka ardhur nga jashtë dhe më merr për të më njoftuar pak me qytetin. Është mbrëmje, mbrëmje e freskët vere (më freskët se në Prishtinë) dhe qyteti ka mjaft gjallëri, pothuajse krejt ndryshe nga ç'e përfytyroja unë për shkak të ngarkesës me informata kryesisht negative ndër vite. Dalim në qytet, ku qarkullojnë jo pak makina dhe ku ka jo pak njerëz në rrugë dhe në kafene, burra e gra dhe pasi e parkojmë makinën diku vizitojmë Bashkinë e Ramallahut, Memorialin e Qytetit, Gjykatën Otomane dhe ndonjë objekt tjetër që s'më kujtohet. Me kërkesën time kthejmë edhe në bankë, që, edhe pse mbrëmje, e gjejmë hapur dhe në prani të sho-

qëruesit këmbëj eurot e para me monedhën e vendit që quhet "shekel". (Palestina nuk ka monedhë të vetën. Në territorin e saj përdoret monedha zyrtare e Izraelit, raporti i së cilës me euron është 4 me 1).

### POEZIA IME KISHTE MBËRRI PARA MEJE NË RAMAHALL


Ndër gjërat e para që marr nga mikpritësi është një pllakat, në të cilin është shtypur, kuptohet në arabisht, poezia ime "Leksion i vogël për Atdheun", në vargjet e së cilës përmendet Palestina. Kjo është njëra nga dhjetë-dymbëdhjetë poezitë e mia të përkthyer arabisht (nga frëngjishtja) enkas për këtë rast. Përkthyes është një poet palestinez, njohës i mirë i frëngjishtes, që punon në ambasadën franceze në Aman. Quhet Valid Suerki. Me vete kam sjellë "Antologjinë e poezisë bashkëkohore të Kosovës", të përgatitur shumëvjet më parë nga poeti me origjinë shqiptarë Abdylatif Arnauti, që jeton në Siri, të botuar në vitin 2003 në Damask, në të cilën unë jam prezantuar me 9 poezi, të marra kryesisht nga dy librat e mi të parë. (Shto këtu edhe pesë poezi, që m'i përktheu miku im, profesor Muhamed Mufaku, të cilin e takova në Prishtinë, pak para se të nisej për në Amerikë, tek e bija, bëhen mbi njëzet).

I lodhur nga rruga, kthehem në hotel, në të vërtetë në konviktin "Saint Andrew's", që gjendet diku në periferi të qytetit, në një nga kodrat e shumta të Ramallahut, në rrugën që mban emrin e poetit të madh spanjoll Federiko Garsia Lorka. "Str. Lorca", shkruan në tabelë, poshtë mbishkrimit në arabisht.

Pasi takoj ndonjë nga poetët mysafirë, që kanë mbërritur ndërkohë, bie të fle me përshtypjet e para nga qyteti i Ramallahut, që është nikoqir i Festivalit, për ta rifilluar të nesërmen në mëngjes ditën e dytë të qëndrimit tim në Palestinë.

(Nesër: Ramallahu dhe muzeu "Mahmud Dervish")


Koha, e mërkurë, 12 shtator 2018



## FOTOGRAFI TË RRALLA, SI REAGONTE BUSH NË 11 SHTATORIN E KOBSHËM

Mediat e huaja kanë zbuluar sot imazhet se si presidenti amerikan, George W Bush reagoi ndaj tmerrit të 11 shtatorit përgjatë gjithë ditës.

Në një koleksion fotografish tronditëse të lëshuara në 17 vjetorin e sulmit terrorist më të keq në tokën e SHBA-së, presidenti Bush mund të shihet duke bërë një telefonatë të panikuar në momentin e saktë kur avioni i dytë goditi Kullat Binjake, transmeton Indeksonline.





## PROFESIONET E HARRUARA TË VITEVE 1800

Revolucioni i dytë industrial dhe progresi i pabesueshëm teknologjik kanë modifikuar në mënyrë radikale markatën e punës dhe stilin e jetës anjeze dhe atë perëndimore në përgjithësi. Mes viteve 1800 dhe 1900 është asistuar në një transformim të vërtetë social, përveçse ekonomik, i cili ka çuar në zhdukjen e disa profesioneve, sidomos në Angli.

Njeriu kundër makinerisë: Një sfidë e stilit 'Chaplin', që ka bërë të shuhen punë të tilla si ndezësi i

llampave të rrugës, shpërndarësi i qumështit apo shoqëruesi i ashensorit.

Lista e profesioneve të harruara është tmerrësisht e gjatë dhe në të gjenden disa profesione vërtet të çuditshme.

Mes tyre bie në sy pa dishim, 'alarmi i zgjimit, njerëzor', apo më sakt, një person i cili endej rrugëve të qytetit dhe trokiste tek dritaret e njerëzve të cilit i kishin besuar atij zgjimin në mëngjes që një ditë më parë.

Një përmbledhje fotosh të

bëra në fillim të viteve 1900 tregon disa profesione të zhdukura me kalimin e viteve, si psh: fëmijë që shesin gazeta në rrugë, punëtorë në një mulli pambuku, ndërtesë të rrotave të trenit, qëndistare jastëkësh e kështu me radhë. Sipas një studimi të bërë nga 'McKinsey Global Institute' në 2017, 49% e punëve që zhvilloheshin nga njerëzit fizikisht në botë, mund të jenë konvertuar në punë që zhvillohen nga makineritë, kur teknologjia penetroi në shkallë botërore.



## SI E SHIHNIN SHQIPËRINË TURISTËT NË VITET 1930

Afërsisht 100 vite më parë turistët e huaj përjashtoheshin nga disa taksa që paguante kategoria "të huaj", duke i dhënë kështu një hov të ri turizmit në Shqipëri, dhe duke promovuar bukuritë shqiptare.

Dokumentet e kohës, të publikuara tashmë online nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme tregojnë korrespondencat e konsullatave dhe legatave shqiptare që kërkonin krijimin e një agjencie turizmi në Shqipëri që të kishte dhe një guidë që udhëzonte turistët e huaj drejt vendit tonë. Madje konsulli shqiptar i kohës në Vjenë rrëfente se turistët kërkonin të vizitonin vende që ishin larg komoditeve të përditshëm të tyre dhe Shqipëria ua ofronte më së miri këtë.

Madje turizmi automobilistik ishte ndër më të frekuentuarit dhe në modë në atë kohë dhe në mjaft media të huaja me emër tu-

ristët kishin shkruar për përshypjet e tyre për Shqipërinë, si N. Koloneli P. T. Etherthon te Daily Mail.

"Në Shkodër në buzë të një nga ma të bukurët liqenë të Shqipërisë bashkuam një gjeneral ingliz...Turisti mund të marr parasysh se deri në verën tjetër, do shkojë mirë kudo në këtë anë të Evropës të pa-njoftun dhe piktoreske. Lamë Shqipërinë me hidhënim dhe u drejtuam për në Serbi në bregdetin dalmasien", shkruante ai në 1927.


Fundi i viteve 20-të dhe vitet 30-të shënuan një vëmendje në rritje të qeverisë shqiptare për organizimin dhe zhvillimin e turizmit në Shqipëri si dhe një angazhim maksimal të legatave dhe konsullatave shqiptare jashtë vendit për të rritur interesimin e të huajve për të vizituar Shqipërinë si turistë.

Kjo punë intensive bëri që Sh-

qipëria në vitet 30-të të ishte pjesë e destinacioneve turistike të perëndimit të Ballkanit, përkrah Jugosllavisë dhe Greqisë, jo vetëm me turizmin automobilistik, por tashmë edhe për turistët që mbërrinin me transport detar në skelat e Durrësit, ose hynin të organizuar nga kufiri verior apo jugor i Shqipërisë.

"Randësinë e turizmit e kanë njoftun mbas luftës botërore shumë shtete të vogla e të mëdha, dhe bajnë shumë sakrificë për me e vu në veprim në gjithë pikëpamjet..", shkruante konsulli shqiptar në Vjenë Çatin Saraçi më 5 gusht 1929

Duke e organizuar turizmin si aktivitet shtetëror, qeveria shqiptare hoqi taksën e vizës për turistët e huaj dhe i pajiste ato me "Kartën e Turizmit" e cila jo vetëm i diferenconte turistët nga



kategoritë e tjera të të huajve që krijonte lehtësira të tjera gjatë qëndronin në Shqipëri, por edhe u ditëve të qëndrimit në Shqipëri.

# DETAJET E REJA PËR MERCEDES GLE TË RI



Pas premierës së modelit të tij të parë plotësisht elektrik SUV, Mercedes ka nisur prodhimin e modelit konvencional. Prodhuesi gjerman ka përgatitur një video ku

paralajmëron premierën e SUV-it GLE. Video nuk zbulon shumë, por në xhirim mund të shihet pjesa e përparme e automjetit me drita speciale LED, transmeton ksp. De-

tajet zyrtare teknike për momentin nuk janë bërë të ditura, por pritet që gjenerata e re e Mercedes GLE të marrë motorin 3.0-litër me gjashtë cilindra e teknologji EQ

Boost, e cila rrit fuqinë e motorit benzinë. Motori standard benzinë është me kapacitet prej 376 kuajfuqi, ndërsa në version EQ Boost është me 398 kuajfuqi.

Në Evropë nuk do të mungojë as versioni në dizel, sikurse është motori me gjashtë cilindra 3.0-litër me 286 kuajfuqi, ndërsa përmendet edhe motori më i fuqishëm dizel me 340 kuajfuqi. Më vonë, në ofertë do të gjendet edhe versioni sportiv nga kuzhina e Mercedes-AMG, me shenjat GLE 53, GLE 63 dhe GLE 63 S. Më i fuqishmi prej tyre do të jetë me motor 4.0-litër V8 me 612 kuajfuqi. Ende nuk dihet se kur do të mbahet premiera e Mercedes GLE, ndërsa rasti i parë për këtë mund të jetë panairi i ardhshëm i veturave në Paris, i cili mbahet ka mesi i tetorit.



## Instagrami do të vijë me një risi që do çmendë vajzat

Instagrami është një nga rrjetet sociale që po përdoret gjithmonë dhe më shumë dhe po lë në hije rrjete të tjera si Facebook apo Snapchat.

Instagrami po sjellë për përdoruesit risi të shumta herë pas here dhe duket se po na e bën jetën më të thjeshtë.

Pas opsionit IGTV, përmes të cilit mund të ngarkonim video më të gjata se 1 minutë, Instagrami vjen me një tjetër risi. Sipas The Verge, shumë shpejt Instagrami do të mundësojë opsionin IG Shopping, i cili i dedikohet blerjeve online shumë thjeshtë, nëpërmjet Instagramit. Ende nuk dihet se kur do të lançohet ky aplikacion, por shumica e llogarive të biznesit, të cilat janë rreth 15 milionë, do të përfitojnë nga kjo gjë.

## Si ta arrini jetëgjatësinë e baterisë së celularit

Edhe pse telefonat celularë janë përmirësuar ndjeshëm në shumë aspekte, bateria e tyre nuk ka fuqinë e dikurshme.

Ditët kur njerëzit prisni që bateria e celularit të tyre të zgjaste një ditë të tërë kanë kaluar, pasi në ditët e sotme ne i përdorim ato shumë më shumë se normalisht. Por ekzistojnë disa mënyra që mund ta bëjnë telefonin tuaj të rrijë i ndezur për një kohë më të gjatë. Sipas Stuff, njerëzit duhet të mbajnë nivelin e baterisë mbi 50



për qind, të kenë më shumë se një karikues dhe të rregullojnë parametrat e telefonit.

Normalisht, njerëzve iu thuhet që para se të karikojnë telefonin e tyre duhet ta lënë që ba-

teria të bjerë plotësisht, por faqja e internetit Stuff thotë se kjo mënyrë nuk është e duhura. Një nga këshillat kryesore është që telefoni të karikohet nga pak, por rregullisht, në mënyrë që bateria të zgjasë sa më shumë. Rekomandohet gjithashtu që njerëzit të investojnë në blerjen e disa karikuesve.

Çdo përdorues duhet të ketë një karikues për në shtëpi, një për vendin e punës dhe një për ta mbajtur në makinë.

## Aplikacioni Facebook po hiqet gjithmonë e më shumë nga celularët



Facebook-u po zhduket gjithmonë e më shumë në mesin e të rinjve dhe zhgënjimi me platformën kryesore të mediave sociale po shtrihet edhe te përdoruesit më të vjetër. Sipas të dhënave të reja nga Qendra Kërkimore e Pew, që përfshin përdoruesit e Facebook-ut të moshës 18 vjeç e lart, 42% e atyre që janë anketuar, kanë marrë "pushime" nga rrjeti social për "disa javë ose më shumë" gjatë vitit të kaluar. Ndërkohë, një e katërta e të anketuarve thanë se e kanë fshirë plotësisht aplikacionin celular nga telefonat e tyre. Sondazhi i Pew u krye mes 29 majit dhe 11 qershorit, kohë kur skandali i privatisë së Cambridge Analytica të Facebook ishte ende i freskët në mendjen e përdoruesve. Por është një shenjë alarmuese që tregon se njerëzit kanë një shije të keqe në gojën e tyre nga Facebook-u pas disa muajsh duke dëgjuar rreth ndërhyrjeve në zgjedhje, fushatave të keqinformimit dhe praktikave të diskutueshme të moderimit.

## Robotët në industrinë e ndërtimit

Të kesh robotë për të bërë pjesët e vështira dhe të lodhshme të punës, është një ëndërr që po bëhet realitet në biznesin e ndërtimit. Zhvilluesit e teknologjisë së automatizimit thonë se robotika po e transformon industrinë, duke e bërë atë më të sigurt dhe duke i ndihmuar kompanitë të marrin më shumë projekte dhe t'i përfundojnë ato më shpejt. Ndërtimi është një nga industritë ku kërkohen gjithnjë punëtorë të kualifikuar. Këtu, një anëtar i ri po i bashkohet ekipit të punës për shtrimin e tullave në ndërtimin e një shkolle të re.

Është SAM, shkurt për "Semi-Automated Mason", një robot i krijuar nga kompania me qendër në Nju Jork, "Construction Robotics". SAM mund të vendosë rreth 3.000 tulla në ditë – disa herë më shumë se sa një murator i zakonshëm. "Shtysa për krijimin e këtij roboti ishte dëshira për të zbuluar teknologji që do të më lejonin të bëja më shumë vëllim pune dhe të plotësoja kërkesat e klientëve të mi, duke bërë më shumë punë për përballimin e tyre", thotë Todd Berich, president i kompanisë Berich Masonry. Ish inxhinieri i kompanisë Google, Noah Ready-Campbell, është themelues i kompanisë së re "Built Robotics", e cila po krijon teknologji për makinat e rënda të ndërtimit, pa shofer.

"Ka projekte me vlerë 1 trilion dollarë për rrugët, urat, shkollat dhe çdo gjë tjetër që duhet të ndërtohet, apo mirëmbahet dhe rinovohet. Por frenuesi më i madh për



t'i bërë të gjitha këto është kostoja. Pra, në se shkurtojmë koston e gërmimeve, nivelimit dhe përgatitjes, atëherë mund të realizojmë më shumë punë për projekte që ka nevojë vendi ynë", thotë Noah Ready-Campbell, drejtor ekzekutiv i kompanisë "Built Robotics". Dronet janë gjithashtu pjesë e kësaj vale të automatizimit. Ky avion mund të inspektojë një zonë prej 36 hektarësh në 25 minuta – një punë, që merr një ditë të tërë, po të bëhet me një sistem lazer të montuar në kamion.

Ai është krijuar nga "Kespry", një kompani në Silicon Valley, që konverton të dhënat e vëzhgimit në harta të hollësishme 3 dimensionale. "Pra, përparësia është tek piketimi që është jo vetëm më i sigurt dhe më i shpejtë, por të jep më shumë të dhëna, dhjetë deri në 100 herë më shumë të

dhëna, së bashku me faktin që ke një dron që fluturon vetë për të mbledhur gjithë të dhënat", thotë George Mathew, drejtor ekzekutiv i kompanisë Kespry. Por automatizimi nuk do t'i lërë njerëzit me domosdo pa punë. "Ne kemi nevojë për të gjithë robotët që mund të marrim, plus të gjithë punëtorët që punojnë për të patur rritje ekonomike. Por, ajo që do të ndodhë, është se ndërsa makinat fillojnë të bëjnë një pjesë të punës që kanë bërë njerëzit, këta duhet të bëjnë punë të tjera, që do të thotë, se do të jetë i nevojshëm ritrajnimi", thotë Michael Chui, i Institutit "McKinsey Global".

Automatizimi po riorganizon industrinë e ndërtimit, duke përcaktuar një peizazh të ri, ku njerëzit dhe robotët punojnë së bashku.

# NGA E HËNA HYN NË FUNKSION TARIFA PËR KALIMIN NË RRUGËN E KOMBIT

Përdoruesit e shpeshtë të kësaj rruge do të përfitojnë reduktime të ndjeshme të tarifit. Për 20-30 kalime në muaj, përfitojnë 10% zbritje

Në datën 17 shtator 2018 nis tarifimi në autostradën Milot-Morinë, ku invalidët e punës dhe shtresat në nevojë do të kenë zero tarifim dhe paketë lehtësuese për banorët e qarkut Kukës dhe çdo kategori tjetër. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka publikuar video informuese me detajet e tarifimit dhe kategoritë që përfitojnë reduktime të ndjeshme të tarifimit.

Tarifa për kalimin e automjeteve në autostrada Milot-Morinë do të jetë 660 lekë (ose 5 euro). Për banorët qarkut Kukës kjo tarifë është e reduktuar në 100 lekë me tvsh. Për çdo kalim deri në 44 kalime tarifa është 100 lekë përfshirë edhe tvsh-në.

Tarifat variojnë sipas llojit të mjetit; motoçikletat dhe automjete me tre rrota do të paguajnë 330 lekë, përjashtim bëjnë banorët e qarkut Kukës të



cilët do ta kenë tarifën 50 lekë.

Automjete komerciale me dy akse dhe 6 rrota (1.90 m dhe 2.70 m) do të paguajnë 1490 lekë. Kamionë të mesëm dhe autobuzë të rëndë, përfshirë mjete me lartë 2.7 m do të të paguajnë 21 40 lekë. Kamionë të rëndë 4 akse a më shumë, do të paguajnë 2970 lekë. Përdoruesit e shpeshtë të kësaj rruge do të përfitojnë reduktime të ndjeshme të tarifit.

Për 20-30 kalime në muaj, përfitojnë 10% zbritje

Për 30-50 kalime në muaj përfitojnë 20% zbritje

Për 50-60 kalime në muaj përfitojnë 30% zbritje dhe mbi 60 kalime përfitojnë 40% zbritje.

Aplikimi i tarifimit të auto-

stradës si një standard ndërkombëtar, siguron garanci dhe siguri në qarkullim të mjeteve dhe lëvizshmëri të qytetarëve. Qytetarët e Kukësit në datën 31 Mars u ngritën në protestë për të kundërshtuar këtë taksë. Protestuesit i vunë flakën sporteleve ku paguhej tarifa për Rrugën e Kombit, hoqën trarët dhe goditën më mjete të forta strukturën metalike. Ishte një protestë që zgjati disa orë.

Në orën 19:00 të asaj dite Kryeministri Edi Rama deklaroi se përdoruesit më të shpeshtë të autostradës, banorët e zonave afër do të paguanin një tarifë më të reduktuar.

Një ditë më vonë u arrestuan

23 persona pjesëmarrës në protestë të cilët u akuzuan për "shkatërrim të pronës", "shkatërrim i pronës me zjarr", "kundërshtim i punonjësve të policisë" dhe "kryerje e veprimeve arbitrare".

Shoqëria Civile në Tiranë organizoi disa protesta në mbrojtje të protestuesve të Kukësit.

9 nga personat e arrestuar mbetën në burg, kurse të tjerët morën masën "detyrim paraqitjeje" dhe "arrest shtëpie".

Të arrestuarit u liruan nga Gjykata e Lartë në Tiranë, më pas nga Gjykata e Apelit e Shkodrës dhe tre të arrestuarit e fundit u liruan në muajin qershor nga Gjykata e Kukësit në të cilën ishte transferuar çështja.



## Thaçi: Beteja me Serbinë zhvillohet në Bruksel

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në një intervistë për RTL-in kroat, ka thënë se do të jetë shumë e vështirë të arrihet paqja me Serbinë, por mënyra e vetme drejt zgjidhjes është dialogu.

RTL-i kroat shkruan se gjatë vizitës në Kosovë të lejuar nga autoritetet kosovare, Vuçiqi e ka shokuar publikun me një fjalim skandaloz në Mitrovicë, në të cilin, duke e rikujtuar tubimin në Gazimestan, ku Slllobodan Millosheviqi e ka mbajtur fjalimin para mijërave njerëzish, e ka përshkruar Millosheviqin si "lider të madh serb".

Thaçi ka thënë që dihet botërisht që Slllobodan Millosheviqi ka qenë kasap i Ballkanit, që nga Slllovenia deri në Kosovë dhe se në mënyrë të drejtpërdrejtë është përgjegjës për gjenocidin e kryer në Kosovë.

"Glorifikimi i tij, tash kur janë shtuar përpjekjet për arritjen e paqes, sipas presidentit kosovar janë një gabim shumë i madh", shkruajnë mediat kroate.

I pyetur nga RTL kroat nëse është befasuar nga dalja relativisht e dobët e serbëve në tubimin e Vuçiqit, Thaçi ka thënë se nuk merret me numrin e njerëzve që kanë marrë pjesë dhe se për të është shumë më i rëndësishëm fakti që vizita ka kaluar pa incidente.

# HARADINAJ: LOJA ME KUFIJ, EKSPERIMENT I RREZIKSHËM

"Ajo që vazhdoj ta them është se është eksperiment i rrezikshëm loja me kufij dhe territore. Jam kundër eksperimenteve dhe lus të gjithë që të kenë kujdes pasi duhet të jemi të vetëdijshëm se loja me kufij e dimë nga e kaluara se sa herë janë hapur nuk ka pasur garanci se kur mbyllen. Kosova nuk duhet pasur ndryshime terroresh e kufijsh", ka thënë Haradinaj



"Ne gjatë gjithë këtij viti pune rëndësi i kemi dhënë shumë punë të shtëpisë qeverisëse dhe mendojmë se ecja përpara e Kosovës është tek konsolidimi i brendshëm edhe në ligj, siguri e ekonomi. Sa i përket dialogut, është temë e rëndësishme dhe kemi interes në këtë temë, qeveria asnjëherë si ka ikur obligimeve të veta, e dini se z.Arifi është përfaqësues i delegacionit të Kosovës në dialogun e mbetur deri në arritje të marrëveshjeve. Ne kemi propozuar Limajn, që të kryeson një delegacion politik

dhe shpresojmë që edhe opozita ta përkrahin pasi kemi pas mungesë të përkrahjes nga Lista Serbe dhe opozita për këtë delegacion por do të shohim si do të rrjedhin gjërat. Nuk quhet insistim por ne kemi një zgjidhje në të mirë të qytetarëve dhe të proceseve të brendshme dhe atyre të jashtme, pra mendoj se është në interes të Kosovës që të ecim përpara dhe mos të mbesim të bllokuar", ka thënë Haradinaj, transmeton Indeksonline.

Kryeministri Haradinaj ka përmendur edhe ndihmën e ofruar

për Preshevën lidhur me Parkun e Paqes e që sipas tij përkrahja për shqiptarët në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc nuk do të ndalet asnjëherë.

"Unë para një kohe, kam pas nderin me e kryesuar qeverinë dhe që qeveria e vendit tim të ndajë një shumë të caktuar të parave për Parkun e Paqes në Preshevë, ne do ta mbajmë çdoherë vëmendjen dhe interesimin për shqiptarët që jeton në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc. Ndërsa për këto tema duhet përkujtuar që detyra ime është zbatimi i Kushtetutës dhe ajo na obligon edhe në territor, edhe në kufi edhe në integritet territorial dhe sovranitet. Unë shërbej në emër të qytetarëve dhe besoj jemi qeveria e parë që ka shkruar aq përpara me përkrahje, kemi komunikim shumë të mirë për mbijetesën e shqiptarëve në atë pjesë. Për të gjitha të tjerat unë kam qëndrim të rezervuar për shkak se jam kryetar i qeverisë dhe i obligohem Kushtetutës së ven-

dit dhe integritetit territorial të kufijve. Ajo që vazhdoj ta them është se është eksperiment i rrezikshëm loja me kufij dhe territore. Jam kundër eksperimenteve dhe lus të gjithë që të kenë kujdes pasi duhet të jemi të vetëdijshëm se loja me kufij e dimë nga e kaluara se sa herë janë hapur nuk ka pasur garanci se kur mbyllen. Kosova nuk duhet pasur ndryshime terroresh e kufijsh", ka shtuar Haradinaj.

"Ne jemi të kujdesshëm në procese dhe duhet ti bëjë thirrje shqiptarëve në Maqedoni të votojnë refreznumin për emrin, për Maqedoni në NATO, pasi ishte shpëtim jetësh kur ne ishim të rrezikshëm. Maqedonia, Kosova dhe gjithë rajoni fiton nga kjo. Ne kemi marrëdhënie shumë të mira me qeverinë e Malit të Zi. Tema me rëndësi tani është liberalizimi i vizave dhe zbatimi i agjendës evropiane dhe të vetmin presion kohor që kemi është liberalizimi dhe nuk do të heqim vëmendjen nga kjo", ka përfunduar ai./Indeksonline/



# 17 VITE PAS SULMEVE, PËRKUJTOHEN VIKTIMAT E “11 SHTATORIT” NË SHBA

Rreth 3.000 persona humbën jetën në sulmet e 11 shtatorit, pjesa më e madhe e të cilëve pas shembjes së dy kullave binjake të Qendrës Botërore të Tregtisë, mbi të cilat u përplasën avionët e terroristëve

Kjo e martë shënoi përvjetorin e 17 të sulmeve terroriste të 11 shtatorit 2001. Për çdo amerikan, imazhet tronditëse, tmerri dhe trishtimi i asaj dite janë ende të gjalla.

Presidenti amerikan, Donald Trump, 17 vite pas atentateve të 11 Shtatorit 2001, shkoi të martën në Shanksvill për të bërë homazhet, ashtu si George W. Bush dhe Barack Obama, për heronjtë e fluturimit 93.

Pranë kësaj qyteze të vogël të Pensilvanisë, që ndodhet rreth 200 kilometra në veriperëndim të Uashingtonit, u mor një prej katër avionëve të rrëmbyer nga anëtarët e Al Kaedës.

Të informuar me telefon për



sulmet kundër kullave të “World Trade Center”, pasagjerët u përpoqën të marrin kontrollin e avionit që u rrëzua në një fushë, duke mos e arritur objektivin e tij, kryeqytetin federal amerikan.

Rreth 3.000 persona humbën jetën në sulmet e 11 shtatorit, pjesa më e madhe e të cilëve pas shembjes së dy kullave binjake të Qendrës Botërore të Tregtisë, mbi të cilat u përplasën avionët e terroristëve. Një tjetër avion u përplas mbi Pentagon, ndërsa i katër-

ti, si pasojë e rezistencës heroike të pasagjerëve, u rrëzua në një fushë në Pensilvani.

Këto kanë qenë sulmet më vdekjeprurëse terroriste në tokën amerikane, pas të cilave asgjë nuk ishte njësoj si më parë në SHBA, por edhe në botë.

Pas këtyre sulmeve, zemërimi u derdh mbi “Al Kaedën”. Shtetet e Bashkuara reagan duke nisur luftën ndaj terrorit dhe pushtuan Afganistanin. Edhe pse fillimisht udhëheqësi i “Al Kaedës” mohoi

përfshirjen, në vitin 2004 mori përsipër përgjegjësinë për sulmin.

Pasi qëndroi në arrati për më shumë se një dekadë, Bin Laden u vra në Pakistan nga një skuadër speciale e marinsave amerikanë. Ndërkohë, shumë vende të tjera forcan ligjet antiterror pas 11 shtatorit dhe zgjeruan kompetencat e agjencive ligjzbatuese dhe atyre të zbulimit, me qëllim që të parandalonin sulme terroriste të mundshme.



## Një në pesë francezë në situatë të vështirë ushqimore

Pamundësia për të ngrënë tre vakte në ditë dhe të ushqyerit në mënyrë të shëndetshme është një realitet për gati një në pesë francezë, sipas një sondazhi të publikuar sot dhe të punuar nga “Ipsos-Secours”. Më pak se një e katërta e francezëve të anketuar (21%) kanë deklaruar se nuk janë në gjendje që të sigurojnë ushqime të shëndetshme dhe të hanë tre vakte në ditë. Ndërsa 27% e tyre kanë pranuar se nuk kanë mjetet financiare për të blerë çdo ditë fruta dhe perime. Gjithashtu, më shumë se një në dy francezë, të ardhurat mujore të të cilit janë nën 1 200 euro shprehet se ka vështirësi për të paguar ushqimin e fëmijëve dhe gati një në dy (48%) vlerëson se ka vështirësi që të sigurojë variacion në ushqime. (ATSH)



## “Reporterë pa Kufij” kundër lajmeve të rreme

Përballë fake news dhe krizës së besimit që kërcënon demokracinë, organizata “Reporterë pa Kufij” (RSF) ka ngritur një komision të pavarur të përbërë nga fitues të çmimit Nobel, gazetarë dhe juristë që të hartojnë një deklaratë ndërkombëtare mbi informacionin dhe demokracinë, 70 vite pas Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut. “Kjo deklaratë ka për objektiva të përcaktojë parime, objektiva dhe të propozojë modele qeverisjeje. Ajo mund të shërbejë gjithashtu si referencë për të gjithë që duan të ruajnë një hapësirë publike të lirë dhe pluraliste, kusht për demokracinë”, shpjegon RSF-ja në një komunikatë. Për të redaktuar këtë tekst, RSF-ja ka krijuar një komision të pavarur, të drejtuar nga iranian, Shirin Ebadi fitues i çmimit Nobel për Paqen dhe nga sekretari i përgjithshëm i këtij çmimi, Christophe Deloire. Komisioni përbëhet nga 24 personalitete që vijjnë nga 17 vende të ndryshme. (ATSH)

## Rusia, gati për stërvitjen më të madhe ushtarake në 40 vite

Rusia përgatitet të zhvillojë stërvitjet më të mëdha ushtarake në gati 40 vjet duke filluar të martën në Siberinë lindore.

Ministri i Mbrojtjes Sergei Shoigu tha se pesë ditët e manovrave ushtarake do të përfshijnë 300,000 ushtarë, 36,000 automjete ushtarake, 1,000 avionë dhe 80 anije luftarake.

Ai tha se stërvitjet janë më të mëdhatë që nga viti 1981, kur Bashkimi Sovjetik ishte ende në Luftën e Ftohtë me Shtetet e Bashkuara.

Ushtria ruse thotë se stërvitjet masive, të njohura me kodin Vostok-2018, janë thjesht mbrojtëse.

“Manovrat nuk janë të drejtuar kundër vendeve të tjera dhe janë në përputhje me doktrinën tonë ushtarake, e cila është mbrojtëse në natyrën e saj”, tha Valeri Gerasimov, shefi i shtabit të përgjithshëm të Rusisë.

Kina po planifikon të marrë pjesë për herë të parë në stërvitjet



ushtarake ruse, duke dërguar 3,200 trupa. Presidenti kinez Xi Jinping do të jetë në Rusi këtë javë për t'u takuar me presidentin Vladimir Putin në një forum ekonomik në qytetin e Lindjes së Larg-

me Vladivostok.


Stërvitjet zhvillohen në një kohë tensionesh mes Perëndimit dhe Rusisë, duke përfshirë akuzat për ndikimin rus në çështjet perëndimore dhe konfliktet në Ukrainë



dhe Siri.

Marrëdhëniet ndërmjet Perëndimit dhe Rusisë u përkeqësuan ndjeshëm pasi Rusia aneksoi Krimenë në 2014 dhe pas një rebelimi pro-rus në Ukrainën lindore.

  
 This project is funded by the European Union

  
 EUREP

  
 Cross Border Cooperation Programme

**Komuna e Dibrës në kuadër të projektit "Standardet dhe Certifikimet Bujqësore, Ndërtimi i Kapaciteteve për Strategjitë e Grumbullimit të Fondeve dhe Marketingu për Mbështetjen e Zhvillimit dhe Tregtisë"** (IPA / 2017390/646), financuar nga Fondet e BE-së (IPA Bashkëpunimi Ndërkufitar), shpall:

**SHPLLJE PËR PUNSIM**

**"Konsulent për implementimin e sistemeve të menaxhimit të cilësisë për ndërtimin dhe zbatimin e standardeve për cilësinë dhe sigurinë e ushqimit". (Referenca 5.2.7)**

Punëdhënësi: Komuna e Dibrës Lloji i kontratës: Afatshkurtër (Kontratë Shërbimi) Postuar më: 12 Shtator, 2018	Vendndodhja: Dibrë-Maqedoni Kohëzgjatja e pritshme: zgjat 7 muaj Afati i fundit për aplikim: 22 shtator 2018
---	--

**Informacion i përgjithshëm**  
 Në zbatim të projektit të financuar nga BE mbi "Standardet bujqësore dhe certifikatat, ngritja e kapaciteteve për përhithjen e fondeve dhe strategjitë e marketingut për të mbështetur rritjen ekonomike dhe tregtinë" Komuna Dibrë po punon me fermerë dhe agro – përpunues potencialë me qëllim që të risë ndërgjegjësimit e tyre lidhur me sistemet e menaxhimit të cilësisë për të përfunduar certifikatat përkatëse të Sistemeve të Menaxhimit të Cilësisë. Komuna Dibrë do të bashkëpunojë ngushtë me përfutuesit e përzgjedhur për të ngritur dhe vënë në zbatim SMC të tilla si: Global G.A.P., Organic production, ISO 22000, ISO 9001 dhe HACCP. Për këtë arsye, Komuna Dibrë kërkon të kontraktojë një konsulent, që do të ngrejë dhe implementojë Sisteme të Menaxhimit të Cilësisë për fermerët dhe agro – përpunuesit e përzgjedhur. Procesi do të vijojë me mbështetjen e ofruesit të shërbimeve për inspektimin dhe certifikimin e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë. Qëllimi final i këtij procesi është certifikimi i suksesshëm i përfutuesve të projektit.

**Përsëritimi i punës**  
 Roli i Konsulentit për Implementimin e Sistemeve të Menaxhimit të Cilësisë është i lidhur me ndërtimin dhe vënien në zbatim të standardeve të cilësisë dhe sigurisë ushqimore për përfutuesit e projektit që janë fermerë ose kompani agro – përpunues. Konsulenti do të bashkëpunojë ngushtë me Koordinatorin e Programit dhe Koordinatorin e Projektit në përzgjedhjen e përfutuesve potencialë që shfaqin interes për certifikimin e produkteve të tyre për të pasur akses në tregjet e BE-së. Konsulenti do të ndihmojë përfutuesit të certifikohen me sukses sipas Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë që kanë implementuar (Global G.A.P., Prodhim Organik, ISO 9001, ISO 22000 ose HACCP).

**Detajat dhe përgjegjësitë e Konsulentit të Implementimit të SMC-ve**

- ✓ Të bashkëpunojë ngushtë me Koordinatorin e Programit, Koordinatorin e Projektit dhe përfutuesit e projektit për një implementim të suksesshëm të standardeve të cilësisë dhe sigurisë të tilla si: Global G.A.P., Prodhim Organik, ISO 9001, ISO 22000, HACCP, etc.
- ✓ Të mbështesë përfutuesit e projektit në hartimin e procedurave, udhëzimeve, analizave të riskut dhe planeve të menaxhimit në përputhje me kërkesat e SMC-ve.
- ✓ Të ndërtojë sistemeve të mbajjes së evidencave dhe rekordeve për të monitoruar implementimin e standardeve.
- ✓ Të kryejë vlerësime të brendshme të standardeve të implementuara.
- ✓ Të bashkëpunojë ngushtë me trupat e inspektimit dhe certifikimit për një certifikim të suksesshëm të përfutuesve të projektit.
- ✓ Të koordinojë trajnimet dhe workshope me përfutuesit e projektit.
- ✓ Të marrë pjesë në aktivitetet monitorimi dhe vlerësimi.
- ✓ Të kontribuojë në vendosjen e targeteve dhe objektivave në konsultim me Koordinatorin e Projektit.
- ✓ Të hartojë raporte përkujtimore dhe të indikatorëve të dhënave nëse kërkohet nga Koordinatorin i Projektit.
- ✓ Të përmblotë në kohë të gjitha dokumentet, raportet dhe detajat që i janë ngarkuar.

**Aftësitë e kërkuesit dhe kualifikimet**

- ✓ Eksperiencë e provuar për zhvillimin dhe vënien në zbatim të sistemeve të sigurisë dhe cilësisë ushqimore (Global G.A.P., Prodhim Organik, ISO 9001, ISO 22000, HACCP).
- ✓ Të paktën 2 vjet përvojë në standardet e sigurisë dhe cilësisë ushqimore.
- ✓ Njohuri të mira lidhur me teknologjinë e prodhimit dhe agro – përpunimit.
- ✓ Aftësi të mira për të punuar në grup dhe nën trynisi.
- ✓ Sistematik dhe i mirëorganizuar në punë.
- ✓ Aftësi të mira komunikimi verbale dhe në të shkruar.
- ✓ Menaxhues i mirë i kohës, aftësi të mira personale dhe organizative.
- ✓ Gradë Universitare e Avancuar në Inzhinieri Agronomike, Teknologji Ushqimore ose fushave të ngjashme. Grada Master dhe kualifikimet shtesë përbëjnë një avantazh.
- ✓ Njohuri të mira të gjuhës angleze, si në të shkruar dhe në të folur.
- ✓ Njohuri të mira të Microsoft Office (Outlook, Word, Excel dhe Power Point).


**4. Si të aplikoni**


Kandidatët e kualifikuar dhe të interesuar duhet të aplikojnë duke dorëzuar një biografi personale CV të shoqëruar me një letër motivimi në adresat:


[ediklobucishta@gmail.com](mailto:ediklobucishta@gmail.com), [dibra@dibra.gov.mk](mailto:dibra@dibra.gov.mk) dhe [Ilir.Pilku@pbs.al](mailto:Ilir.Pilku@pbs.al), më së voni deri në afatin e lartë përmendur me shenjëzim (nënvizim) "Konsulent për implementimin e sistemeve të menaxhimit të cilësisë për ndërtimin dhe zbatimin e standardeve për cilësinë dhe sigurinë e ushqimit". Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen.

Kryetar  
Ruzhdi Lata

Nr. 09-732/1  
11.09.2018

  
 This project is funded by the European Union

  
 EUREP

  
 Cross Border Cooperation Programme

**Komuna e Dibrës në kuadër të projektit "Standardet dhe Certifikimet Bujqësore, Ndërtimi i Kapaciteteve për Strategjitë e Grumbullimit të Fondeve dhe Marketingu për Mbështetjen e Zhvillimit dhe Tregtisë"** (IPA / 2017390/646), financuar nga Fondet e BE-së (IPA Bashkëpunimi Ndërkufitar), shpall:

**SHPLLJE PËR PUNSIM**

**"Inspektimet dhe Certifikimet e Agrobiznesit Lot 1. Certifikatat organike, HACCP dhe ISO 22000"**  
(Referenca 5.2.5)

Punëdhënësi: Komuna e Dibrës Lloji i kontratës: Afatshkurtër (Kontratë Shërbimi) Postuar më: 12 Shtator, 2018	Vendndodhja: Dibrë – Maqedoni Kohëzgjatja e pritshme: 7 muaj Afati i fundit për aplikim: 22 shtator 2018
---	--

**Përsëritimi i projektit**  
 „Standardet bujqësore dhe certifikimet, ngritja e kapaciteteve për thithjen e fondeve dhe strategjitë e marketingut për të mbështetur rritjen ekonomike dhe tregtinë“ është projekt dy vjeçar i financuar nga BE-ja që mbështet zhvillimin e Bujqësisë në rajonet e Dibrës në Maqedoni dhe Peshkopi si një nxitës i rritjes ekonomike për zonën kufitare. Projekti zbatohet nga një partneritet rajonal me Agjencinë Rajonale të Zhvillimit 2-Tiranë dhe Komunitetin e Dibrës si partner, dhe Creative Business Solution si partner kryesor.

**Qëllimi i Projektit**  
 Projekti ka për qëllim të forcojë kapacitetet prodhuese të SME-ve dhe qasjen në treg, të nxisë investimet në teknologjitë moderne dhe të risë eksportet. Si pjesë e ndërhyrjeve të tij, projekti do të zhvillojë një grup agrobiznesesh në zonën ndërkufitare që do të fuqizohet nëpërmjet tre komponentëve: (I) Certifikimi i produkteve bujqësore dhe ofrimi i trajnimeve të përshtatura për të rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e certifikatave; (II) Përgatitja e paketave të sakta të aplikacioneve për programet e BE-së dhe të grantëve të kombinuara me trajnime për ngritjen e kapaciteteve për të rritur kapacitetet absorbuese të fondeve; (III) Shërbimet e Konsulencës së Integruar për Strategjitë e Marketingut duke përfshirë markimin, etiketimin dhe marketingun digital.

**Fushë veprimi i detyrës**  
 Kompania e kontraktuar do të sigurojë shërbim për kontroll/inspektim dhe certifikim për Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë si në vijim:

**1. HACCP- 2 (dy) certifikata, 2. ISO 22000 - 2 (dy) certifikata, 3. Organik -2 (dy) certifikata**

Kompania e kontraktuar do të bashkëpunojë ngushtë me Komunitetin e Dibrës për batimin e sistemeve të menaxhimit të cilësisë.

Organi certifikues ka përgjegjësinë të caktojë inspektorë dhe menaxherë cilësorë (jo-kyç) dhe me aftësi adekuate profesionale për të kryer procesin e auditimit / inspektimit, vlerësimit dhe certifikimit të sistemeve të menaxhimit të cilësisë.

Profilin dhe detajat që duhet të kryhen nga ekspertët (jo-kyç) që do të përfshihen nga kompania / kompanitë e kontraktuara janë si në vijim:

**Detajat dhe Përgjegjësitë e Inspektorëve/ekspertëve (Organi i Certifikimit)**

- Kryerja e inspektimeve të jashtme në ambientet e përfutuesve dhe në vendet e prodhimit sipas sistemeve të kërkuesit të menaxhimit të cilësisë: Organike, HACCP dhe ISO22000
- Zbatimi i procedurave për të trajtuar mospërputhje dhe veprime korigjuese që mund të rezultojnë nga auditimet e jashtme dhe /ose inspektimet, ankesat e konsumatorëve ose dështimet e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë.
- Raportimi në kohë i veprimeve korigjuese dhe ndjekja e tyre deri në përfundim
- Hartimi i raporteve të sakta dhe në kohë për inspektimet e jashtme

**Detajat dhe Përgjegjësitë e Menaxherëve të Cilësisë (Grup i Certifikimit)**

- Vlerësim profesional dhe në kohë të raporteve të auditimit të jashtëm të Sistemeve të Menaxhimit të Cilësisë që sigurohen nga inspektorët;
- Marrja e vendimit përfundimtar të certifikimit në rast se fermerët / agroturistët kanë zbatuar me sukses sistemin e menaxhimit të cilësisë.
- Dorëzimi i një raporti përfundimtar në Komunitetin e Dibrës për nivelin e zbatimit të sistemeve të menaxhimit të cilësisë për rastet e refuzuara, ose Letrën e Certifikimit për ato që kanë të drejtë.

**Kërkesat e stafit**

**Aftësitë e kërkuesit dhe kualifikimet e Inspektorit dhe Menaxherit të Cilësisë**


- Diplomë universitare të avancuar në Inzhinieri Bujqësore, Teknologji Ushqimore ose në fusha të ngjashme; Diploma master ose kualifikimet shtesë janë një avantazh
- Minimum 5 vjet përvojë profesionale në inspektim dhe vlerësim për Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë (Rregullorja EEC 834/07), ISO 9001, ISO 22000 dhe HACCP);
- Akreditimi si inspektor ose menaxher i cilësisë duhet të vërtetohet nëpërmjet certifikatave përkatëse;
- Marrëdhënie të shkëlqyera ndërkufitare dhe shkathtësi koordinuese, krijuese dhe fleksibile;
- Aftësi të forta në përpunimin e raporteve të inspektimit dhe vlerësimit;
- Aftësi të avancuara të komunikimit me gojë dhe shkrim në gjuhën angleze;


**Si të aplikoni?**

Kandidatët e kualifikuar dhe të interesuar duhet të aplikojnë duke paraqitur CV-në aktuale bashkë me letër Motivuese në adresimin: [ediklobucishta@gmail.com](mailto:ediklobucishta@gmail.com), [dibra@dibra.gov.mk](mailto:dibra@dibra.gov.mk) dhe [Ilir.Pilku@pbs.al](mailto:Ilir.Pilku@pbs.al), më së voni deri në afatin e caktuar me theksin/nënvizimin "Inspektimet dhe Certifikimet e Agrobiznesit, Lot 1. Certifikatat organike, HACCP dhe ISO 22000". Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen.

Kryetar  
Ruzhdi Lata

Nr. 09-733/1  
11.09.2018





Në bazë të nenit 35 ndërsa në lidhje me nenin 51, paragrafi 10 i Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16), Kryetari i Komunës së Karposhit, në vijim sjellë

**LAJMËRIM**

Për organizim të prezantimit publik dhe anketës publike për Projektin arkitektonik-urbanistik për ndryshim të kufirit të PN 1.6.2 dhe PN 1.6.3.1 në pajtim me PDU Momin Potok, KK Zllokuqni, Komuna e Karposhit – Shkup.

Anketa publike për Projektin arkitektonik-urbanistik për ndryshim të kufirit të PN 1.6.2 dhe PN 1.6.3.1 në pajtim me PDU Momin Potok, KK Zllokuqni, Komuna e Karposhit – Shkup, do të mbahet prej më 17.09.2018 deri më 21.09.2018, çdo ditë pune prej ora 07.30 deri më 15.00, në lokalet e Komunës së Karposhit (Baraka 2 – rr. Radika nr. 9).

Prezantimi publik për Projektin arkitektonik-urbanistik për ndryshim të kufirit të PN 1.6.2 dhe PN 1.6.3.1 në pajtim me PDU Momin Potok, KK Zllokuqni, Komuna e Karposhit – Shkup, do të mbahet më datë 19.09.2018 në ora 13.00, në lokalet e Komunës së Karposhit (Baraka 2 – rr. Radika nr. 9).

Përfshirja projektuese kapë parcelat ndërtimore 1.6.2 dhe 1.6.3.1 në të cilat korniza janë përfshirë pjesë e PK 850 KK Zllokuqani, pjesë e PK 851/1 KK Zllokuqani, pjesë e PK 851/3 KK Zllokuqani dhe pjesë të PK 7094/1 KK Zllokuqani.

Sipërfaqja e përfshirjes së hapësirës për të cilën ka të bëjë ky Projekt arkitektonik-urbanistik është P= 7857,04 m2.

Listat anketuese për pjesëmarrje në Anketën publike do të gjenden në lokalet e Komunës së Karposhit (Baraka 2 – rr. Radika nr. 9) dhe në sistemin E-urbanizam

Lajmërimi për organizim të prezantimit publik dhe anketës publike, shfaqja grafike do të publikohen në UEB faqen e Komunës së Karposhit - [www.karpos.gov.mk](http://www.karpos.gov.mk) dhe në sistemin informativ E-urbanizam.

Në afatin e caktuar, subjektet e interesuara juridike dhe fizike, mund të parashtrojnë vërejtjet në listat anketuese në lokalet e Komunës së Karposhit (Baraka 2 – rr. Radika nr. 9) dhe në formë elektronike përmes sistemit informativ E-urbanizam, në pajtim me nenin 35 paragrafi 5 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16).

**KRYETARI I KOMUNËS**  
**I KOMUNËS SË KAPOSHIT**  
**Stefan Bogojev**

Në bazë të nenit 13 paragrafi 1, ndërsa në lidhje me nenin 10 paragrafi 3 të Vendimit për kushtet dhe mënyrën e dhënies me qira të pronës së patundshme në pronësi të Qytetit të Shkupit nga data 30.10.2014, Vendimit të Këshillit të Shkollës së SHMQSH "Nikolla Karev" – Shkup nr. 02 652/5 të datës 27.8.2018 dhe Vendimit të drejtorit për formim të komisionit 02-748/1 të datës 04.09.2018 SHMQSH "Nikolla Karev" – Shkup publikon

**SHPLLJE**

Për dhënie me qira të hapësirës shkollore

**QIRADHËNËS:**  
SHMQSH "Nikolla Karev" – Shkup, me seli në rr. "Nikolla Rusinski" Shkup

**1. OFERTUES:**  
Të drejtë për parashtimin e ofertave kanë të gjitha subjektet e interesuara juridike të vendit.

**2. LËNDA E QIRASË:**

1. Terrene sportive dhe objekte në kuadër të funksionit të terreneve me sipërfaqe të përgjithshme prej 2650 m<sup>2</sup> edhe atë:
  - Fushë futboll – sipërfaqe prej 800 m<sup>2</sup>
  - Dy fusha tenisi – sipërfaqe prej 1050 m<sup>2</sup>
  - Fushë basketbolli – sipërfaqe prej 300 m<sup>2</sup>
  - Fushë voleybolli – sipërfaqe prej 300 m<sup>2</sup>
  - Hapësirë për shërbim të pijeve në pjesën e fushave me terrace me sipërfaqe prej 200 m<sup>2</sup>
2. Garden qendër me sipërfaqe prej 700 m<sup>2</sup>
3. Hapësirë në objektin e shkollës dedikuar për shërbime hotelerike sandviç bar, me sipërfaqe prej 40 m<sup>2</sup>.
4. Terminë në sallën e edukatës fizike me kohëzgjatje prej 60 minutave gjegjësisht 1 orë.

**3. ÇMIMI FILLESTAR:**  
Shuma fillestare e qirasë mujore të hapësirës që jepet me qira, ndërsa do të jetë lëndë e ankandit publik është:

- Për terrene sportive dhe objekte në kuadër dhe funksion të terreneve me sipërfaqe të përgjithshme prej 2650 m<sup>2</sup> çmimi fillestar 39 686,00 denarë
- Për garden qendër me sipërfaqe prej 700 m<sup>2</sup> çmimi fillestar 19 742,00 denarë
- Për hapësirën në shkollë dedikuar për veprimtari hotelerike sandviç bar, me sipërfaqe prej 40 m<sup>2</sup> çmimi fillestar prej 12 385,00
- Terminë në sallën e edukatës fizike në kohëzgjatje prej 60 minutave gjegjësisht 1 orë çmimi fillestar prej 800 denarë.

Shuma minimale për rritje të shumës fillestare të qirasë në ankandin publik është 5% të shumës së caktuar fillestare.

- 3.1 Lënda e qirasë është e ndashme.
- 3.2 Hapësira që është lëndë e qirasë jepet me qira për periudhë prej 1 (një) viti.

**4. Kohëzgjatja e fillimit të ankandit publik:**

- 4.1. Për secilën lëndë veç e veç do të limitohet veçmas:
  - 4.1.1. Ankandi publik është caktuar më datë 25.09.2018 në ora 11:00. Ankandi do të fillojë me lëndën e parë të pikës 2 gjegjësisht me terrenet sportive, dhe do të vazhdojë me lëndët tjera për qira në kohëzgjatje prej 30 minutave për secilën pjesë veç e veç.
  - 4.1.2. Ankandi do të realizohet në hapësirat e shkollës.

**AFATI DHE MËNYRA E PARASHTRIMIT TË OFERTAVE:**  
Shpallja zgjatë 15 ditë nga dita e publikimit të saj në gazetën ditore "Sloboden pečat" në gjuhën maqedonase dhe në gazetën "Koha" në gjuhën shqipe.

SHMQSH "Nikolla Karev" – Shkup  
Komisioni për dhënie me qira të hapësirës së shkollës

Disa nga mediat më të mëdha botërore, si Reuters, kanë raportuar për ndeshjen e mbrëmshme të Kosovës kundër Ishujve Faroe, të cilën Kosova e fitoi me rezultat 2-0. Ky rezultat shënoi fitoren e parë të Kosovës në një ndeshje me karakter garues në historinë e saj

Kosova vazhdon ta shkruajë historinë e futbollit të shtetit tonë duke regjistruar fitoren e parë në kuadër të Ligës së Kombeve. Ndashja e zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë përfundoi me fitoren e vendasve me rezultat 2-0.

Fraksioni i parë i sfidës së vlefshme për Grupin 3 në ligën D të Ligës së Kombeve, u mbyll pa gola. Skuadra jonë e pati dominimin dhe iniciativën në 45 minutat e para, mirëpo mungoi konkretizimi.

Të zgjedhurit e Bernard Chandandes bënë një lojë sulmuese duke e mbajtur kundërshtarin të mbyllur në pjesëlojën e vet.

Por, ishte mesfusha ajo që në këtë ndeshje ishte reparti më i organizuar mirë dhe kjo fal dyshes Hekuran Kryeziu dhe Herolind Shala. Ky i fundit pas triumfit në Ligën e Kombeve ka shkruar në Instagram duke treguar se kujt ia dedikon këtë tre pikësh.

"Kjo është Kosova. Fitorja shkon për presidentin Vokrrin dhe për gjithë ju tifozët tanë". Krahas posedimit të mirë të topit, ekipi nikoqir pati edhe disa raste të mira shënimi.

Theksojmë se në gjysmën e parë, tifozët e Kosovës e kanë nderuar edhe një herë legjendën e futbollit shqiptar, Fadil Vokrri. Në ndeshjen e parë të zhvilluar në stadiumin e Prishtinës që mban pikërisht emrin e futbollistit legjendar dhe presidentit ikonik të Federatës së futbollit të Kosovës, tifozët kishin përgatitur një koreografi të veçantë.

Ndashja e ardhshme e Kosovës është kundër Maltës, ajo do të luhet në vendin tonë më 11 tetor 2018.

Në ndeshjen e parë përfaqësuesja jonë barazoikundër Azerbajxhanit pa gola.


#### JEHONA NË MEDIAT E HUAJA

Disa nga mediat më të mëdha botërore, si Reuters, kanë raportuar për ndeshjen e mbrëmshme të Kosovës kundër Ishujve Faroe, të cilën Kosova e fitoi me rezultat 2-0.

Ky rezultat shënoi fitoren e parë të Kosovës në një ndeshje me karakter garues në historinë e saj.

Ndashja ishte e vlefshme për rundin e dytë të ndeshjeve të grupit të tretë, ligës D, në kuadër të

# KOSOVA E DOMINON SFIDËN NDAJ ISHUJVE FAROE



turneut të Ligës së Kombeve.

Ndashja ishte edhe më e veçantë për shkak ishte ndeshja e parë që Kosova do ta luante në shtëpi, në stadiumin "Fadil Vokrri", i cili u licencua nga UEFA muajin e kaluar, raporton Gazeta Express.

Reuters shkruan se Kosova e ka mposhtur skuadrën e Ishujve Faroe për të siguruar kështu fitoren e tyre të parë.

"Kosova e mposhtin skuadrën e Ishujve Faroe për ta siguruar fitoren e parë me karakter garues", thuhet në titullin e kësaj medie.

Edhe gazeta gjermane, Spiegel, ka raportuar për ndeshjen e Kosovës, duke u fokusuar në reagimin e lojtarëve nga golave të shënuar.

"Futbollistët e Kosovës e festojnë fitoren e parë me karakter garues në histori të tyre", shkruan

e ish-presidentit të Federatës së Futbollit të Kosovës dhe futbollistit legjendar, Fadil Vokrrit.

"Kosova e feston fitoren e parë në histori të tyre", shkruan Di Marzio.

#### FUTBOLLISTËT E KOSOVËS KANË NJË KËRKESË PAS FITORES NDAJ ISHUJVE FAROE

Të lumtur për fitoren në përrimin e stadiumit të rikonstruktuar "Fadil Vokrri", duke nderuar legjendën e futbollit kosovar, por të vetëdijshëm edhe për aspektet që duhen përmirësuar në lojë. Samir Ujkani, Milot Rashica dhe Atdhe Nuhiu flasim "me këmbë në tokë" pas suksesit me Ishujt Faroe.

**SAMIR UJKANI:** Ne kemi luajtur njësoj si në pjesën e parë dhe në të dytën. Nuk është e lehtë t'i lësh në stol disa lojtarë të mirë dhe sërish të ruash atmosferën në ekip, ky është mentaliteti ynë. Në Azerbajxhan morëm një pikë shumë të

madhe, sepse fusha ka qenë shumë e rrezikshme. Ne duhet të shikojmë ndeshje pas ndeshjeje, pa e patur mendjen te të tjerët. Mbështetja e tifozëve është shumë e rëndësishme për ne në fushë".

**MILOT RASHICA:** "Ishte ndeshja e parë që kemi luajtur në shtëpi dhe kemi patur përkrahjen shumë të madhe të tifozëve tanë. Bashkëpunimi është shumë i mirë në treshen e ofensivës dhe gjatë lojës kemi mundësi të ndryshojnë anët, duke respektuar edhe taktikën e trajnerit".

**ATDHE NUHIU:** "Tri pikë kanë qenë shumë të mëdha. Megjithatë s'duhet të kënaqemi shumë, sepse duhet ende të përmirësohemi. Kemi lojtarë jashtëzakonisht të mirë. Në çdo rol kemi nga dy lojtarë dhe secili po jep më të mirën. Duhet të mendojmë lojë pas loje dhe të shohim se ku do të mbërrijmë".



Christian Panucci ka lëkundur ndjeshëm pozitativat e tij, pas humbjes me Skocinë në Glasgow, një ndeshje në të cilën kuqezinjët, përpos humbjes u panë në vështirësi shumë të mëdha

Veç gjendjes jo të mirë fizike, ekipi duket se vuajti ndryshimet e skemës, që siç pohuan edhe lojtarët me zë dhe nën zë, ishin deri diku të paprovuara.

Gjithmonë thuhet se është e lehtë të analizosh kur përfundon gjithçka, por në 10 ndeshje, 9 skema të ndryshme dhe dhjetëra lojtarë të provuar thuajse nuk funksionuan asnjëherë.

Kanë qenë rreth 15 lojtarët e rinj që ka grumbulluar trajneri Panucci që nga korriku i vitit 2017, kur mori drejtimin e Shqipërisë, por thuajse asnjëri prej tyre nuk mundi të lërë gjurmë, për të qenë brez i së ardhmes, apo pjesë e ekipit që mban vulën e pasuesit të De Biasit.

Kryefjala e çdo grumbullimi të Christian Panuccit ka qenë disiplina, lojtarët që largohen dhe thirren në grumbullimet pasardhëse për eksperiencën, apo për të plotësuar vendet e lojtarëve të dëmtuar

# HUMBJA ME SKOCINË LËKUND POZITAT E PANUCCIT



e me pak minuta aktivizim.

Prania e kapitenit Agolli në këto dy ndeshje u pa vetëm në konferencat për shtyp, ndërkohë që në futboll thuhet se formacioni fitues nuk ndryshon. Mesfusha e paraqitur mirë në ndeshjen ndaj Izraelit, me Bashën në krye apo Hykën, u ndryshua 3 ditë më pas pa ndonjë arsye bindëse, ndryshim që rezultoi jo i suksesshëm.

Fitorja me Izraelin, thjesht i dha një frymëmarrje atmosferës

mbytëse të krijuar nga një presion i drejtë rezultatesh. Ndërkohë, tani pas humbjes në Skoci, gjithçka zbret në vendin ku ishte, në të njëjtën atmosferë, presion e pasiguri.

Teorikisht jemi me 3 pikë në grupin tonë, aq sa edhe Skocia, por luajmë në Izrael ndeshjen e ardhshme me frikën se nuk dimë çfarë na pret, kush do të luajë dhe mbi të gjitha si do të luajmë.

Një pikëpyetje që e ka shoqë-

ruar trajnerin Panucci përgjatë të gjithë këtij viti që na udhëheq, edhe pse vlen të thuhet se për fatin e tij jo të mirë, aventura e drejtimit të një përfaqësuese filloi nga një Shqipëri në tranzicion.

Shumica e lojtarëve janë pa minuta në këmbë, me dëmtime të shpeshta, e disa madje edhe pa ekipe për të luajtur në mënyrë të vazhdueshme, duke sjellë një kolaps mendimi për një zgjidhje të së ardhmes.

Në anën tjetër, Mediat britanike kanë kritikuar lojën e Shqipërisë së Panuccit përballë Skocisë, duke e konfirmuar si një skuadër jo në nivelin e trumbetuar kohët e fundit.

E përditshmja britanike "The Guardian", e ka cilësuar në shkrimin e saj Shqipërinë si një "kundërshtar të limituar". Sipas saj "nuk i përket atyre që e kanë kthyer 'Hampden Park' një vend për t'u pasur frikë nga ekipet kundërshtarë pasi nuk entuziazmoi tifozërinë. Skocia e meritoi plotësisht fitoren. Pas golit të dytë, Shqipëria nuk dukej asnjëherë e aftë të kthehej në lojë".

Ndërkohë, "Daily Mail" thekson më shumë faktin që Balaj nuk do të harrojë lehtë këtë natë. "Sulmuesi i Akhmat Groznit do të kthehet i stresuar në shtëpi, pasi humbi një tjetër rast të jashtëzakonshëm pas krosit të Ndoj", shkruan e përditshmja britanike.

"The Herald" kujton golin e famshëm të Panuccit ndaj Skocisë dhe e cilëson "një lloj hakmarrje" fitoren e sotme, duke kujtuar se ironikisht Shqipëria kishte fanellat e bardha, si Italia e vitit 2007.

Sa i përket "The Sun", ai thekson se fitoja e Skocisë ishte "bindëse" ndërsa në pjesën e parë i mungoi "cilësia para portës e si rrjedhojë edhe goli që erdhi në të dytën". Ndërkohë, pas 2-0, e përditshmja britanike thekson se golin e tretë e evitoi vetëm ndërhyrja në momentet e fundit e mbrojtësve shqiptarë. (Top Channel)

## Trajneri i Skocisë, McLeish: E merituar fitoren, e respektojmë Shqipërinë

Trajneri i Përfaqësueses së Skocisë, Alex McLeish, foli për RTSH pas ndeshjes së fituar kundër Kombëtares së Shqipërisë me rezultatin 2-0. Ai theksoi se ekipi i tij e kishte merituar fitoren dhe se është i kënaqur me paraqitjen e skuadrës.

"Jam i kënaqur me skuadrën time, pasi bënë një lojë mjaft të shpejtë. E merituar fitoren".

"Kishim shumë raste, por kishim dhe kishim më shumë presion. Edhe Shqipëria kishte rastet e saj, por ne kontrolluam lojën".

"Ne e respektojmë Shqipërinë, nuk e prisim kështu. Shqipëria ka lojtarë që luajnë në nivele të larta".

"Ne kishim topin gjatë gjithë ndeshje. Ata bënë ndeshjen e tyre", u shpreh Meklish pas ndeshjes, shkruan SportEkspres. Ndeshja e ardhshme e Shqipërisë në Ligën e Kombeve është kundër Izraelit.



## Kupa e Shqipërisë, të mëdhenjtë 'shpërfillin' trofeun

Edicioni i ri i Kupës së Shqipërisë ka nisur, ku nga dy përballjet e para është Oriku dhe Veleçiku që do të vijojnë garën, pasi kanë eliminuar respektivisht Elbasanin dhe Klosin. Këto dy skuadra sërish i presin përballje të vështira, duke qenë se i presin Skënderbeu dhe Kukësi. Oriku do të përballlet me Kukësin, ndërsa Veleçiku me Skënderbeun. Për të vijuar me përballje të tjera që mendohet se janë të lehta në letër, për shembull ajo mes Tërbunit dhe Partizanit, Shkumbini me Flamurtarin apo Naftëtari—Laçi. Ndërkohë që ka ndeshje të tjera që mund të jenë interesante, si sfida mes Burrelit dhe Vllaznisë, Tomorrit dhe Bylisit, Pogradecit dhe Apolonisë apo Besëlidhjes me Erzenin apo Dinamos me



Egnatian. Natyrisht që ka skuadra që duan ta mbyllin shpejtë këtë kapitull, por ka edhe të tjera që duan ta vijojnë më tepër. Normalisht që garë do të ketë në ndeshjet mes skuadrave që kanë pothuajse të njëjtën cilësi. Ndërsa ekipe të tjera të Superiores

mund ta nënvlerësojnë turin e parë eliminator, për shkak se kanë kundërshtarë të lehtë përballë dhe mund të aktivizojnë vetëm të rinjtë. Një farë shpërfilljeje e këtij turi, duke qenë se niveli i kundërshtarëve nuk do të jetë i njëjtë.

## Tronditet bota e futbollit, ish-futbollisti vritet me armë zjarri

Ish lojtari i Saint Etien Uilliam Gomis ka ndërruar jetë. Këtë lajm e ka konfirmuar klubi francez. 19-vjeçari, që u largua nga Liga 1 këtë verë pas 5 viteve të luajtura aty, thuhet se u qëllua për vdekje në La Seyne-sur-Mer, një komunë franceze pranë Toulon, edhe pse rrethanat rreth vdekjes së tij ende nuk janë konfirmuar. Policia tha

se në vendngjarje janë gjetur 24 gëzhoja kallashnikovi. Edhe një djalë 14 vjeç thuhet se vdiq gjithashtu në po këtë rast. Gomis kishte qenë pjesë e Saint Etien që në moshën 15 vjeç. Futbollisti do të mbushte 20 vjeç në muajin dhjetor 2018. Të gjithë pjesëmarrësit e klubit shprehën ngushëllime për ndarjen nga jeta të futbollistit.





Nëse është e vërtetë, atëherë kjo nuk do të pritët mirë. Për këtë bazohuni vetëm te reagimi i tifozëve kur u njoftua se disa ndeshje të La Ligas mund të zhvillohet në SHBA



## Atletiko i Madridit përfitoi nga largimi i Ronaldos

Diego Simeone pohon se klubi që ai e drejton, Atletico Madrid, tani është në një nivel me rivalin e vet, Real Madridin, falë largimit të Cristiano Ronaldos.

Për më tepër, Simeone nuk mund ta kuptojë sesi Antoine Griezmann është injoruar nga nominimet për çmimet e FIFA-s. Real Madridi e fitoi Ligën e Kampionëve për herë të tretë në sezonin 2017-18, me Cristiano Ronaldon që përsëri ishte shtylla kryesore në këtë triumf me 15 golat e tij.

Por, kapiteni i Portugalisë e braktisi La Ligën për t'iu bashkuar Juventusit për 100 milionë euro në korrik.

Tani, Simeone beson se ekipi i tij, që e mbylli sezonin e kaluar një vend më lart se Real Madridi në La Liga, të cilin edhe e mposhti në Super Kupën e UEFA-s në gusht, është në një nivel me rivalin e qytetit.

"Bazuar në rezultate, ne nuk jemi më të dobët se Barcelona apo Real Madridi, por nga karakteristikat individuale të lojtarëve tanë, jemi", tha Simeone.

"Pa Ronaldon, tani i natyrisht se iu kemi afruar nivelit të Real Madridit", shtoi ai.

# PLANIFIKOHET QË FINALJA E CHAMPIONS LEAGUES TË ZHVILLOHET JASHTË EVROPËS

Champions League është njëra prej garave më eksituese për tifozët e futbollit. Natyrisht se bëhet edhe më spektakulare në finale kur zhvillohet në ndonjë stadium gjigant evropian.

Por, gjërat mund të ndryshojnë. Kështu të paktën shkruan

London Evening Standard, gazetë e cila pohon se elita e futbollit evropian mund ta zhvendosë finalen në Nju Jork për herë të parë në histori.

Jaume Roures, i cili është shef ekzekutiv i kompanisë televizive, Mediapro, ka zbuluar se është bërë

një debat i hapur për zhvendosjen e finales në SHBA, transmeton IndeksOnline.

"Bisedimet janë duke vazhduar për mundësinë e zhvillimit të finales së Champions Leagues në Amerikë", tha Roures për Catalunya Radio. Nëse është e vërtetë, atëherë

kjo nuk do të pritët mirë. Për këtë bazohuni vetëm te reagimi i tifozëve kur u njoftua se disa ndeshje të La Ligas mund të zhvillohet në SHBA. Kuptohet se finalja më e afërt e Champions Leagues që pritët të zhvillohet në Evropë do të jetë ajo e vitit 2020 apo 2021.

## Lorik Cana i rikthehet futbollit por jo në Shqipëri



Lorik Cana edhe pse ka dhënë "doreheqjen" nga futbollit, kurrësesi nuk do të largohet nga ky sport.

Së fundmi ai ka konfirmuar se shumë shpejt do të jetë drejtues i një klubi futbollit.

Cana ka folur për "Lalaziosiamoni" ku është shprehur:

"Kam një fondacion në Kosovë, ku jam themelues dhe president, punoj me të vegj-

lit. Merrem pak edhe me televizion, por brenda dy viteve do të filloj një karrierë si drejtues në botën e futbollit profesionist."

"Nuk dua absolutisht të largohem nga bota e futbollit, do të bëj gjëra të tjera nëpërmjet fondacionit dhe TV-së, por kam dëshirën që të provoj botën e drejtuesve. Ku? Jo në Shqipëri, por gjithsesi në Europë" ka shtuar Cana.

Publicitet

## Mancini në telashe



Trajneri italian, Roberto Mancini, ishte i shqetësuar pas humbjes 1-0 ndaj Portugalisë në Lisbonë në ndeshjen e vlefshme për Ligën e Kombeve.

Një performancë e dobët e skuadrës së tij në ndeshjen e së premtes me Poloninë që përfundoi me rezultatin 1-1.

Një tjetër natë pa ngjyra ishte ajo se mbrëmjes së djeshme për "axurrët", që kanë vënë jo pak në pikëpyetje kualifikimin e skuadrës.

Mancini pas ndeshjes ishte shumë i zhgënjyer dhe deklaroi se skuadra duhet

të reagojë sa më shpejt.

"Lojtarët e rinj duhet të rriten, nuk kemi shumë alternativa. Duhet të përmirësohemi në aspektin fizik, kështu çdo gjë do të ishte më e lehtë për ne. Skuadra nuk është shumë e rrezikshme në momentin që sulmon". "Na mungon fantazia për të zgjidhur situatat e ndryshme në lojë. Kemi shumë punë për të bërë", u shpreh Mancini.

"Nuk jemi të rrezikshëm përballë portës së kundërshtarit. Nuk jemi në gjendje të shënojmë, ky është problem që duhet zgjidhur", deklaroi tekniku i Italisë.

Me vendim të Këshillit të shkollës për dhënie me qira të hapësirës afariste – kuzhinë me numër arkivues 02-138/5 të datës 28.6.2018, SHFK "Krumë Kepeski", Komuna e Kisella Vodës – Shkup publikon

### SHPALLJE PËR MARRJE ME QIRA TË HAPËSIRËS nr. 3/2018

#### I. LËNDË E SHPALLJES

Në bazë të Vendimit për realizim të procedurës për dhënie me qira të hapësirës afariste, SHFK "Krumë Kepeski" – Shkup realizon procedurë për dhënie me qira të hapësirës afariste kuzhinës së shkollës për shërbime hotelerike edhe atë për përgatitjen dhe shërbimin e ushqimeve për nxënësit dhe nxënësit në qëndrim ditor në shkollë për periudhë prej 2 (dy) vite mësimore.

#### II. KUSHTET PËR DHËNIE ME QIRA TË HAPËSIRËS

Qiraja mujore për hapësirën është 30.000,00 denarë me tatim të përfshirë të vlerës së shtuar prej 18%. Në qiranë mujore nuk janë të përfshira shpenzimet që dalin nga shfrytëzimi i rrymës, ujit dhe bërllokut të cilat enkas do të përcaktohen nga gjendja faktike.

Pagesa e qirasë është mujore edhe atë për 16 (gjashtëmbëdhjetë) muaj, gjegjësisht për muajt shtator, tetor, nëntor, dhjetor, shkurt, mars, prill, maj, deri më 10 qershor gjatë viteve mësimore 2018/2019 dhe 2019/2020 në pajtim me menynë mujore të definuar në dokumentacionin tenderues të publikuar nga ana e Byrosë për furnizime publike në pjesën e "Shpalljeve të tjera" më datë 11.09.2018.

#### IV. MËNYRA E REALIZIMIT TË VEPRIMTARISË

Ushqimi (mëngjes dhe drekë) do të përgatiten në pajtim me normat e caktuara për ushqim shoqëror të nxënësve, në pajtim me rregullat për ushqim të shëndoshë dhe kualitativ përshtatur me moshën e kësaj popullate dhe meny mujore (listë të ushqimeve) që është pjesë përbërëse e këtij dokumentacioni tenderues; Mjetet për realizim të marrëveshjes për furnizime publike do të sigurohen nga ana e prindërve të fëmijëve që zhvillojnë mësimin në këtë shkollë dhe tek të cilët do të paraqitet nevoja e llojit të këtillë të furnizimit gjatë vitit shkollor 2018/2019 dhe 2019/2020.

Vërejtje: Operatori ekonomik të cilin do t'i ndahet marrëveshja për furnizime publike në pajtim me Vendimin për zgjedhje të ofertës më të volitshme do të obligohet që nga ana e organit kontraktues të lidhë marrëveshje për dhënie me qira të hapësirës afariste kuzhinë e shkollës në pajtim me kushtet e theksuara me lartë.

# SHAQIRI SHPJEGON SI MUND T'I NDIHMOJË LIVERPOOLIT TA FITOJË PREMIERLIGËN

“Qëllimi është që klubi të fitojë tituj, ky është qëllimi i skuadrës sonë. Ne duhet të tentojmë ta fitojmë çdo ndeshje. Pastaj duhet ta largosh nga mendja ndeshjet e kaluar që e ke fituar dhe të mendosh: ‘Në rregull, tani do të shikojmë përpara dhe ta fitojmë ndeshjen e radhës’. Kështu fitohen titujt dhe shpresoj se do ta bëjmë këtë gjë këtë sezon”, ka thënë Shaqiri



Mesfushori Xherdan Shaqiri, mendon se përvoja që ka për triumfin në gara të ndryshme do t'i ndihmojë Liverpoolit ta fitojë titullin e Premierligës këtë sezon. Për herë të fundit, Liverpooli e fitoi ligën në sezonin 1989/1990, atëherë kur liga njihet me emrin First Division.

Futbollisti i Kombëtares së Zvi-

crës, me origjinë shqiptare, u transferua në Liverpool gjatë afatit kalimtar të verës. Ai u largua nga skuadra e Stoke Cityt, pasi që ata kishin rënë nga Premierliga në Championship, përcjell Gazeta Express.

Shumë gazetarë dhe analistë të sportit kanë thënë se skuadra e Jurgen Kloppit është e vetmja

skuadër që mund ta sfidojë atë të Pep Guardiols, të cilët janë kampionët aktualë.

Edhe pse legjenda e Manchester Unitedit, Gary Neville, e ka kritikuar Shaqirin për sjelljen e tij, ky i fundit mendon se ai mund t'i ofrojë Liverpoolit atë që i nevojitet për të triumfuar në Premierligë. “Qëllimi është që klubi të fi-

tojë tituj, ky është qëllimi i skuadrës sonë. Ne duhet të tentojmë ta fitojmë çdo ndeshje. Pastaj duhet ta largosh nga mendja ndeshjet e kaluar që e ke fituar dhe të mendosh: ‘Në rregull, tani do të shikojmë përpara dhe ta fitojmë ndeshjen e radhës’. Kështu fitohen titujt dhe shpresoj se do ta bëjmë këtë gjë këtë sezon”, ka thënë Shaqiri. “Pikë së pari, ne dëshirojmë të luajmë futboll shumë të mirë. Por, ne gjithashtu e kuptojmë se jo gjithmonë fiton skuadra që luan më mirë, kështu që ne duhet të mësojmë si t'i fitojmë ndeshjet, kjo është e rëndësishme, dhe si të garojmë me skuadrat e tjera”.

“Si lojtar, unë dua ta shfaq talentin tim. Shumica e lojtarëve veçse më njohin mua nga Premierliga dhe për shkak të Bayern Munichut. Unë kam mjaft shumë përvojë”.

“Kam fituar shumë tituj me Bayernin dhe dua të tentoj t'ia jap këtë përvojë skuadrës së Liverpoolit, që është ende shumë e re në moshë. Për këtë arsye, unë do të tentoj t'i ndihmoj për të fituar tituj”.

## Pas arrestimit të tij, ylli i Francës kërkon falje

Portieri francez i Tottenhamit, Hugo Lloris, e ka pranuar se kishte bërë gabim kur vendosi të voziste veturën e tij në gjendje të dehur, gjë për të cilën edhe u arrestua. Ai i ka kërkuar falje të gjithë tifozëve, klubit, si dhe familjes.

Llorisi, i cili triumfoi me Kombëtaren e Francës në turneun e Kupës së Botës në Rusi, ka bërë të ditur se ai është duke e bërë më të mirën e tij për t'u përqendruar në gjërat më të rëndësishme për të, futbollin, shoqëria dhe familja e tij. Në fund të gushtit, Llorisi

ishite arrestuar në Londër pasi që ishte zënë nga policia duke vozitur në gjendje të dehur. Pas këtij incidenti, ai nuk ka luajtur më asnjë ndeshje, as për Tottenhamin e as për Francën, pasi që e ka pësuar një lëndim.

Megjithatë, ai e ka shprehur dëshirën e tij për t'u rikthyer edhe më fuqishëm pas këtij incidenti, për të cilin është penduar shumë.

“Dua t'i kërkoj falje nga zemra familjes sime, klubit, bashkëlojtarëve, trajnerit dhe të gjithë tifozëve”, ka thënë Llorisi në një deklaratë të lëshuar nga Tottenhami



## Trump u tall me Brazilin, trajneri Tite i tregon 'manitan'

Paraqitja e Brazilit në Botëror nuk i përmbushi pritshmëritë pasi u eliminua në çerekfinale nga Belgjika, një fakt i cili nuk i ka shpëtuar as Presidentit të Amerikës, Donald Trump. Më herët gjatë verës Presidenti i Amerikës iu përgjigj një gazetarit brazilian në Shtëpinë e Bardhë duke insistuar se vendi i tij është “më i miri në botë”, por shtoi se “skuadra ka një problem të vogël, dështimin në Botërorin e Rusisë”.

Deri më tani kishte munguar një kundërpërgjigje, e cila ka ardhur nga trajneri i “seleços” Tite, që po përgatit

skuadrën për ndeshjen miqësore kundër El Salvador. Kjo ndeshje do të luhet në Amerikë dhe pikërisht në tokën e Trump ku trajneri Tite ka treguar 5 gishtat kur është pyetur sot për shakanë e presidentit të Amerikës.

Një gjest që tregon numrin Botërorëve të fituar nga Brazili, më shumë se kushdo tjetër. Një numër i bërë i famshëm nga spanjollët si “manita”. Kujtojmë që “FIFA” pas lobimit të fuqishëm të Donald Trump, më herët gjatë këtij viti ka votuar që Botërori i 2026 të zhvillohet në Amerikë, Kanada dhe Meksikë.





**DASHI** 21. mars - 20. prill

Mos u ndjeni të detyruar që të kënaqni të gjitha kërkesat e kolegëve të punës, pasi ky është një moment i rëndësishëm për të organizuar më së miri prioritetet tuaja. Horoskopi i kësaj të marte, këshillon që të jeni më skeptik lidhur me çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me bashkëpunëtorët tuaj.



**DEMI** 21. prill - 21. maj

Në këtë moment duhet të mundoheni që të jeni më të kujdesshëm me shpenzimet, për shkak se po afrohen jo pak çështje të cilat duhet të zgjidhen brenda fundit të muajit. Shmangni debatet aspak produktive në vendin e punës ose do të rrezikoni ngadalësimin e mëtejshëm të projekteve tuaja.



**BINJAKET** 22. maj - 21. qershor

Kjo është një ditë e cila duhet jetuar plotësisht dhe të mos mendoni me ankth për të ardhmen, pasi në këtë moment po jetoni një fazë tranzitore, e cila do mundësojë ndryshime të mëdha. Në dashuri parashikohen momente harmonike.



**GAFORRJA** 22. qershor - 22. korrik

Mundohuni të shikoni me sy më kritik disa nga projektet tuaja. Do të keni mundësi që të bëni ndryshime, bazuar në nevojat tuaja. Do të jeni të drejtpërdrejtë dhe të vendosur dhe kjo gjë do ju lejojë që të merrni një rol drejtues mjaft të rëndësishëm në punë.



**LUANI** 23. korrik - 22. gusht

Kjo është një ditë e rëndësishme për të zgjidhur çdo konflikt në dashuri ose në familje. Megjithatë mundohuni që te veproni me sa më shumë diplomaci dhe të mos dorëzoheni përballë provokimeve të tjerëve. Parashikohen mundësi shumë të mira për të forcuar një raport.



**VIRJERESHA** 23. gusht - 23. shtator

Kjo e martë ju fton që të mos i mbysni emocionet tuaja, pasi kjo është një periudhë e rëndësishme për të riparë të gjitha raportet tuaja ndërpersonale. Do të jeni në kërkim të qetësisë dhe spontanitetit dhe për këtë arsye duhet të mundoheni që të largoheni nga të gjithë personat që ju mërzisin dhe nga gjithë situatat që ju tensionojnë.



**PESHORJA** 24. shtator - 23. tetor

Mundohuni që të mos shpërqendroheni, pasi në këtë moment jeni duke u marrë me negociata mjaft të rëndësishme për karrierën tuaj. Mos ikni nga përgjegjësitë që keni, pasi në këtë mënyrë do të bëheni më të fortë dhe autoritar. Tregohuni kurajoz dhe besojini intuitës tuaj.



**AKREPI** 24. tetor - 22. nëntor

Parashikohet një javë, e cila ju fton që të jeni më të kujdesshëm dhe të duruar, sidomos nëse në vendin e punës po mundoheni që të përmbyllni negociata të rëndësishme. Mbrëmja parashikohet të jetë pasionante.



**SHIGJETARI** 23. nëntor - 21. dhjetor

Do të jeni në kërkim të një stabiliteti më të madh, paqeje dhe qetësie, në të gjitha raportet ndërpersonale. Këto të fundit kanë qenë javë mjaft të turbullta dhe për këtë arsye tani do të jeni në kërkim të një personi që t'iu bëjë të ndiheni të lirë të shprehni siç dëshironi. Përgjigje pozitive janë fare pranë.



**BRICJAPI** 22. dhjetor - 20. janar

Më në fund do të riktheheni të jeni karizmatik dhe të pavarur në vendin e punës dhe në dashuri. Ka ardhur momenti të riktheheni në lojë dhe të përcaktoni qartë prioritetet tuaja. Parashikohen mundësi shumë të mira dhe propozime që duhen vlerësuar seriozisht në vendin e punës.




**UJORI** 21. janar - 19. shkurt

Parashikohet një ditë e cila kërkon që të jeni më të kujdesshëm nga pikëpamja ekonomike, pasi parashikohen shpenzime urgjente të cilat duhet ti trajtoni me kujdes maksimal. Horoskopi i kësaj dite këshillon që të mos lini pas dore të gjitha nevojat e partnerit/es tuaj.



**PESHQIT** 20. shkurt - 20. mars

Kjo e martë sjell me vete një qiell mjaft me fat! Do të jeni dinamik dhe energjik dhe për këtë arsye do të siguronit strategji të rëndësishme për çdo të papritur në vendin e punës. Do të keni mundësi të shumta për të gjetur shpirtin tuaj binjak.



12 SHTATOR 1913  
31 MARS 1980

<b>KOHA</b>	PYLL ME MARE, MARESHTE (SH.)	<b>M</b>	KTHINË E VEÇUAR NË SHTEPI QË PËRDORET PËR NJE QELLM TË CAKTUAR	KOMUNË NË BURGONJË TË FRANCËS (ORIGJ.) (. O.L.L..)	TASTA EKZEKUTIVE E TASTIERËS KOMPJUTERIKE	QYTET NË FRANCË				
QENIA E GJALLË QË USHQEHET NË KURRIZ TË NJË QENIEJE TJETER	ZBULUESI I SAKSOFOINIT									
<b>P</b>	PERËNDIA E DASHURISË TË ROMAKËT E VIJETËR								ZANORE TË NJËJTA	UNANIMISHT (SHKURT.)
FUTBOLLISTI ITALIAN, GABIADINI									XHAXHA, DAJE	PIKTORI UELLSIAN, OSMOND
ISH BASKETB. I NBA-SË, SHEKILL						AUTORI YNË, BULKA				
AKTORJA AMERIKANE, UELLÇ						LASGUSH PORADECI			HOXHË VOKA I DIBRËS, NAJDENI	RUMANIA
ITRIUMI										NJË NGA DISIPLINAT E SPORTISTIT NË FOTO

ZGJIDHJET: KK, XHOKË, ERROR, SPEC, VIALI, O NILL, NONDA, RAKEL, SAIT, IT, SPRINTI, PARAZITI, FË, MANOLO, UNGJ, O NILL, NONDA, RAKEL, SAIT, IT, SPRINTI.

## Sudoku

shumë i lehtë

mesatar

			7								5	4		3	2		1
	7	6	2			4	3						6				
1				9	4			2				2	8	7			
		9		7			4	3	4		8				3		9
		3	4		9	5				3	9		4		8	1	
7	5			2		8			5		7				4		2
5			1	8				6	8			9	7	6			4
	6	7			2	3	1						5				
				7					9			3		8			

Shumë i lehtë: 425738169, 976251438, 138694752, 219875643, 683419527, 754326891, 542183976, 867942315, 391567284. Mesatar: 765493281, 284561793, 193287546, 428615379, 639742815, 517839462, 852976134, 376154928, 941328657.

# ÇIFTI NË KRIZË? 4 HAPA PËR TË SHPËTUAR LIDHJEN

Çështjet e zemrës janë si malet ruse, kalojnë mes ulje-ngritjesh, ku marrëdhënia njëherë duket si një kopësht lumturie dhe njëherë gjithçka e zezë, sikur nuk ka kthim pas. Keni ndjesinë se partneri nuk ju kupton më, mungon në lidhjen tuaj, nuk ka shumë vëmendje, mendon vetëm për

punën dhe miqtë, dhe duket sikur çifti nuk ekziston më. Ja se çfarë duhet të bëni.

**Flisni**—vetëm kështu mund të kuptoni se çfarë po ndodh duke nxjerrë në bisedë dhe gjëra që nuk ia keni thënë në sy njerëi-tjetrit.

Përgjegjësi 50 me 50—Çdo gjë në çift duhet të jetë e bara-



bartë dhe sjellja e njërit ndikon dhe tek tjetri. Nëse partneri ju kritikon hidhni dhe sytë nga vetja çfarë të përmirësoni

**Nevojat**— Në momente krize kujtoni momentet tuaja më të mira dhe do të fitoni ndjesinë se çdo situatë do të rregullohet. Është një ush-

trim vetëdije që do keni nevojë.

**Premtimet**— Që të shpëtoni lidhjen tuaj, bëni premtime të tipit, pasi kam analizuar situatën jam gati t'ia nis nga e para lidhjes tonë me gjëra konkrete që e dini se mund ti mbani.



## Stallone njofton për rikthimin e "Rambo 5"

Sylvester Stallone vazhdon të jetë ndër aktorët më të mirë të industrisë së filmit. Ai njihet për rolin e tij në filmin "Rambo", i cili deri tani ka realizuar katër pjesë të tij. Ndërsa, tani aktori përmes rrjeteve sociale ka njoftuar se "Rambo" po rikthehet me pjesën e pestë. "Fillon së shpejti dhe ndihem shumë i emocionuar... Bota mund të ndryshojë, por jo ai. ASGJË NUK KA PËRFUNDUAR", ka shkruar ai mbi fotografinë me të cilën njoftoi për filmin.

## Pse vjellim pasi të kemi pirë alkool?



Pas një nate të gjatë konsumimi alkooli pjesa më e madhe prej nesh "luten" para tualetit dhe nxjerrin gjithë me ndonjë objekt për t'u ndier më mirë. Pse ndodh kjo? Sipas universitetit të Teksasit në Dallas e vjella ndodh sepse alkooli është në të vërtetë një irritues gastrik dhe alteron stomakun. Në fakt konsumimi i tepërt i alkoolit provokon gastrit. Simptomat variojnë, por përfshijnë mostretje, dhimbje stomaku, nauze, gjendje pështjellimi dhe të vjella. Alkooli etilik gjendet në pijet alkoolike si vera me 13%, birra me 5% pijet diku tek 50% dhe pijet alkoolike deri në 70%, të cilat mund të helmojnë sistemin tonë, nëse konsumojmë shumë në një afat të shkurtër

kohor. Konsumi i tepërt i alkoolit përcaktohet 5 ose më shumë pije gjatë dy orëve për meshkujt dhe 4 për femrat. Arsyeja se pse vjellim është se alkooli pa u vënë re nga ne kalon nga goja në ezofag, në stomak dhe hyn në zorrën e hollë e më pas në rrjedhën e gjakut. Më pas edhe kur nuk pijmë më nivelin e alkoolit në organizëm rritet. Ai thithet shpejt, por eliminohet ngadalë. Sipas një të dhëne nga universiteti i Kolorados e vjella është një seri ngjarjesh. Faza e parë është nauzeja, e cila është e lidhur me një ulje të lëvizshmërisë gastrike ose kontraksione të muskullit të lëmuar gastrik në stomak dhe me rritjen e tonusit të muskullit të murit në zorrën e hollë.

## Ford së shpejti prezanton Transitin e ri në dy versione

Kompania e njohur e automjeteve, Ford, planifikon të forcojë pozicionin e saj në tregun e automjeteve komerciale me gjeneratën e re të modelit Transit. Transiti i ri do të prezantohet në panairin e automjeteve komerciale (tregtare) në Hanover, i cili do të mbahet më 20 shtator, ndërsa në shitje pritet të dalë vitin e ardhshëm. Gjithashtu, Transiti i ri do të jetë në dispozicion në dy versione të cilat ndjekin trendet aktuale - versioni hibrid me teknologjinë 48-voltëshe (mHEV) dhe versioni Transit Custom plug-in hibrid (PHEV). Fordi me Transitin e ri premton më shumë efikasitet të motorit dizel 2.0-litër EcoBlue, më shumë hapë-



sirë për ngarkesa, sistemin e lidhjeve të përmirësuar dhe sistemin e avancuar për ndihmë të shoferit. Sa i përket estetikës, Transiti i ri do të

ketë dizajn të ri të maskës së përparme dhe interior tërësisht të ri me më shumë hapësirë. Transiti 48-voltësh (mHEV) do të vijë me motor

benzinë 1.0-litër EcoBoost dhe atë elektrike, përmes të cilit me vetëm një mbushje do të mund të udhëtojë deri në 500 kilometra.



KALENDARI HISTORIK 12 SHTATOR

1217—Princi francez Lui dhe Mbreti i Anglisë Henri III nënshkruajnë traktat të paqes.

1635—Suedia dhe Polonia nënshkruajnë Traktatin e Stuhmsdorfit për armëpushim.

1683 — Beteja e Vjenës — Disa ushtri evropiane bashkojnë forcat për të zbrapsur Perandorinë Osmane.

1722 — Trupat ruse okupojnë Bakunë dhe Derbentin në Prusi.

1848 — Zvicra bëhet shtet federal.

1934 — Estonia, Latvia dhe Lituania formojnë Antantën Baltike kundër Rusisë

1940 — Trupat italiane futen në Egjipt.

1968 — Shqipëria shpall tërheqjen nga Pakti i Varshavës.

1980—Grushtet ushtarak ndër Gje-neral Kenan Evren në Turqi.

Kur një njeri digjet në diell, enët e gjakut pësojnë aq dëm sa që u duhet katër deri në pesë muaj që tërësisht të shërohen



Shumica e tërmeteve zgjasin më pak se një minutë, ndër-sa valët e tërmetit lëvizin me shpejtësi prej 25.000 kilometra në orë që është 20 herë më shpejtë se zëri!



Flamuri i vetëm në botë i cili ndryshon varësisht nga gjendja e shtetit nëse është në luftë ose në paqe është flamuri i Filipineve. Gjysma e flamurit është me ngjyrë të kuqe dhe gjysma me ngjyrë të kaltër: në gjendje paqeje gjysma e kaltër rri lartë ndërsa e gjysma e kuqe poshtë, ndërsa në gjendje lufte ndodhë e kundërta; e kuqja rri lartë ndërsa e kaltra poshtë.



### Banjoja me muzikë

Ishin kafshët e pyllit dhe kishin ndërtuar një banjo me muzikë nga brenda.

U fut luani brenda dhe pasi mbaroi punë doli dhe i tha te tjerëve:

- Ah sa mirë që ishte me muzikë!

Një dite u fut brenda ariu dhe kafshët e tjera e panë që po u vononte shumë dhe i hapën derën e banjos. Pasi i hapën derën e banjos panë që ariu ishte në këmbë me dorën në zemër dhe banjo ishte bërë shumë pis. Ariu me nerva i tha:

- Po ju tani e gjetët me vënë himnin e flamurit ee????



"Ju gjithmonë keni dy mundësi: T'i pranoni gjërat në mënyrën sesi janë, apo të keni kurajon e duhur për t'i ndryshuar ato".

-Jeckov Kanani.



BARSOLETA



THËNIA E DITËS